

PLANIFIKIMI TEMATIK VJETOR PËR ÇERDHEN

16 mësoj

Mendoj dhe mësoj



Mësoj për shkronjat



Mësoj për kafshët



Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format



Kopshti/Çerdhja: “_____”

PLANIFIKIMI TEMATIK MËSIMOR VJETOR
GRUPI I PARË - Mosha 2 – 3 vjeç
VITI 2024 -2025

Punoi:

Mësuese

Pranoi:

Drejtuese e institucionit

MUAJI TETOR

Tema mujore: Karakteristikat e stinës së vjeshtës

Çfarë duhet të dimë për stinën e vjeshtës? Fjala vjeshtë vjen nga fjala e lashtë etruske "Autu" dhe tregon kalimin nga një stinë në tjetrën. Vjeshta është një nga katër stinët e bukura të vitit, ku natyra merr një pamje përrallore. Karakteristikë e stinës së vjeshtës është zverdhja e gjetheve dhe rënia e tyre në tokë. Klorofili është kimikati që bën pemën të largojë ngjyrën e gjelbër dhe të marrë ngjyrë tjetër. Në vjeshtë, dita nis të bëhet më e shkurtër dhe nata vjen më shpejt. Në vjeshtë, shumë kafshë fillojnë të përgatiten për stinën e dimrit duke mbledhur dhe ruajtur ushqimin nëpër fole dhe strofka apo edhe në yndyrën e trupit të tyre. Studimet kanë treguar se fëmijët e lindur gjatë muajve të vjeshtës kanë gjasa të jetojnë më gjatë se ata të lindur në pjesën tjetër të vitit.

1. **Java I:** Karakteristikat e përgjithshme të stinës së vjeshtës
2. **Java II:** Njohja me element kryesorë të stinës së vjeshtës
3. **Java III:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së vjeshtës
4. **Java IV:** Veshja në vjeshtë

Tema mujore : Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Karakteristika të përgjithshme të stinës	Njohja me elementët kryesorë të stinës si: moti në vjeshtë, shiu, era.	Java I
Njohja me elementët kryesorë të stinës	Njohja me disa element kryesorë si: dielli, qielli, shiu përmes punimeve të vizatimit.	Java II
Njohja e frutave dhe perimeve të stinës	Njohja e frutave, perimeve përmes demonstrimit të përgatitjes së ushqimeve.	Java III

Veshja në vjeshtë	Si vishemi në vjeshtë? Ndryshimi nga veshjet e lehta të verës tek ato më të ngrohtat.	Java IV
-------------------	--	---------

Java I - Tema e javës: Njohja me karakteristikat e përgjithshme të stinës së vjeshtës			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Karakteristikat kryesore të stinës së vjeshtës	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë-Edukatorja u flet/shpjegon rreth karakteristikave kryesore të stinës si: shiu, era, retë, rënia e gjetheve, etj. Si ndryshon moti nga vera në vjeshtë? Pse bie më shumë shi në vjeshtë? Si është qielli? Pse nisin të bien gjethet?</p> <p>Shëtitje: Në oborr me fëmijët (më së shumti 24-36 muaj) për të parë,prekur,mbledhur gjethe/degëza peme (shoqëruar me numërimin e tyre)</p> <p>Vjersha: “ Vjeshta”</p> <p>Loja:” Ngjyrosim me gishta si ngjyrat e vjeshtës”</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 4
E martë	Pasqyrimi i karakteristikave përmes vizatimit	<p>Vizatimi/Ngjyrosja e figurave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët si: forma të reve,të gjetheve etj.</p> <p>Krijimi i tablosë: Ngjitja e gjetheve të mbledhura në oborr (gjatë shëtitjes në ditën e hënë,shoqëruar me numërimin e tyre) Vjersha: “Vjeshta”</p>	Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 4-5
E mërkurë	Ngjyrat e	Bisedë: Edukatore-fëmijë-Edukatorja u shpjegon/pyet fëmijët mbi ngjyrat	Libri “Mësoj për

	vjeshtës	referuar punimeve të ditëve të mëparshme ose përmes ilustrimit të figurave të tjera (revista, punime që disponojnë në grup, etj) Vjersha: “ Vjeshta” Loja: “Punë më plastelinë – gjithja e vjeshtës)	numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 4
E enjte	Pemët dhe gjethet në vjeshtë	Bisedë: Edukatore-fëmijë-Edukatorja u shpjegon/pyet/demonstron mbi pemët Pse bien gjethet në vjeshtë? Si janë ngjyrat e tyre? Vjersha: “Vjeshta” Vizatimi/Ngjyrosja: Pemët & Gjethet me forma të ndryshme. Modele të përgatitura më parë nga edukatoret. Lojra të lira: me formuese, me birrila, puzzle, etj.	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 5
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës. Vjersha: “Vjeshta” Përrallë e lirë: Ilustrim i figurave (sipas librave që disponojmë në grup)	

Java II - Tema e javës: Njohja me elementët kryesorë të stinës			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Qielli & Dielli në vjeshtë	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja pyet fëmijët: Si është dielli/qielli në vjeshtë? Pse qielli është më gri ose me re? Ilustrimi përmes tablove, librave, revistave (të grupit) Vizatimi/Ngjyrosje: “Dielli/Retë” (të ndarë në grupe) Shëtitje: Në oborr me fëmijët (më së shumti 24-36 muaj) – vështrohet dielli, qielli ose nga dritarja. Përrallë e lirë: Ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup).	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 4

E martë	Ditë vjeshte me re dhe shi	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon fëmijëve rreth qielli /retë/shiu. Si janë ditët në vjeshtë? – Me re/me shi.</p> <p>Punëdore: Fëmijët punojnë me plastelinë/fletë punëdore “Retë”.</p> <p>Vjersha: “Shiu”</p> <p>Loja: “Imitojmë rënien e shiut”</p>	Mjete didaktike
E mërkurë	Ditë shiu	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve rreth shiut, përdorimit të çadrës. Çfarë ngjyre ka çadra juaj/Me cilin personazh?</p> <p>Vjersha: “Shiu”</p> <p>Loja: “Ngjitësi që pikon dhe piktura me oriz” (punimi i çadrës)</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 5
E enjte	Çadra ime	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve kur nevojitet çadra? Ngjyrat dhe personazhet e tyre (përforcim i tematikës së ditës së mërkurë).</p> <p>Aktivitet i improvizuar: “Kam dhe unë çadrën time” – Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që t’i pajisin fëmijët me çadra atë ditë – Fëmijët tregojnë / pyesin njëri-tjetrin për çadrën e tyre stimuluar nga edukatorja (shoqëruar me numërimin e çadrave).</p> <p>Vizatimi / Ngjyrosje: “Çadra” – ngjyrosje e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët. Vjersha: “Shiu”</p>	Mjete didaktike
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Shiu”</p> <p>Përrallë e lirë – ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup)</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 5

		Loja: “ Bërja e vulave”	
--	--	--------------------------------	--

Java III - Tema e javës: Fruta dhe perimet e stinës			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me frutat	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve/tregon/demonstron përmes formave plastike, tablove, librave, revistave frutat e stinës. Cilat janë? Cilat fruta pëlqeni?</p> <p>Vjersha: “Ngjyrat e mollës”</p> <p>Vizatimi/Ngjyrosja: “Frutat” – ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët (shoqëruar me numërimin e tyre).</p> <p>Loja: “Tabela e lotos” (specifikisht me figura frutash).</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 6

E martë	Njohja me perimet	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë - Edukatorja u shpjegon fëmijëve/tregon/demonstron përmes formave plastike, tablove, librave, revistave perimet e stinës.</p> <p>Vjersha: “Karrota”</p> <p>Vizatimi/Ngjyrosja: “Perimet” – ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët (shoqëruar me numërimin e tyre).</p> <p>Loja: “Tabela e lotos” (specifikisht me figura perimesh).</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 3
E mërkurë	Përgatitja e ushqimeve	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/pyet fëmijët kush gatuan në shtëpi? Po në çerdhe?</p> <p>Vizitë: Në kuzhinë (24-36 muaj) – shpjegon dhe teta kuzhinierja se çfarë ushqimesh ka përgatitur atë ditë.</p> <p>Lojë: “Fruta dhe perimet – Bëj sikur gatuan” (me zgjedhje)</p> <p>Përralla: “Lejleku dhe dhelpira”</p>	
E enjte	Etika e të ngrënit	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve si shtrohet tavolina.</p> <p>Si ta ndihmojmë mamin/edukatoren në shtrimin e tavolinës? Pse i lajmë duart para dhe pas ushqimit?</p> <p>Vjersha: “Etika e të ngrënit/Dreka” (me zgjedhje) Loja: “Bëj sikur gatuan”</p>	Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 6-7
E premte	Përgatitja e ëmbëlsirës	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja shpjegon/pyet cilat ëmbëlsira na pëlqejnë?</p> <p>Çfarë ëmbëlsirash bën mami/gjyshja në shtëpi?</p> <p>Lojë: “Numërojmë biskotat/Brumi për të luajtur” (improvizim përgatitja e kekut)</p>	

		Panairi i frutave dhe ëmbëlsirave: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë një frut ose një ëmbëlsirë të përgatitur në shtëpi (shoqëruar me numërimin).	
--	--	---	--

Java IV - Tema e javës: Veshja në vjeshtë			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Veshja e fëmijëve në	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/pyet fëmijët si vishemi? Pse veshim bluzë me mëngë të gjata? Pse veshim	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”,

	vjeshtë	<p>atlete/këpucë? Pse vishemi më lehtë në verë dhe pak më trashë në vjeshtë?</p> <p>Loja: “Vjeshta”</p> <p>Vizatimi/Ngjyrosja: “Veshjet e fëmijëve” – ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorja.</p> <p>Përralla: “Tre derrkucët”</p>	faqe 7
--	---------	--	---------------

E martë	Veshja për vajzat	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon fëmijëve veshjet për vajzat në vjeshtë. Çfarë fustani/triko/geta/streçe ke veshur ti... Ana...?</p> <p>Loja: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin veshje për vajzat: fundi /fustani/triko (me copa/fletë punëdore).</p> <p>Loja: “Veshja e kukullës” (improvizim i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura nga aktiviteti i mësipërm). Vjersha: “Jam një vajzë simpatike”</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 6
E mërkurë	Veshja për djemtë	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon fëmijëve veshjet për djemtë në vjeshtë. Çfarë pantallonash/bluzë/atlete ke veshur ti... Gimi...?</p> <p>Loja: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin veshje për djemtë: pantallona/bluzë/jelek (me copa/fletë punëdore).</p> <p>Loja: “Veshja e kukullës/Arushave” (improvizim i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura nga aktiviteti i mësipërm). Vjersha: “Gimi i vogël”</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 6
E enjte	Ekspozita e veshjeve	<p>Loja: Paraqitja në tablo e veshjeve/mini – ekspozitë të përgatitura në grup ose të sjella nga vetë fëmijët. Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë veshje të tyre në çerdhe.</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike”</p> <p>Përralla: “Masha dhe ariu”</p>	Veshje të ndryshme
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p>Loja: “Veshja e kukullës” (improvizimi i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura gjatë javës).</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Gimi i vogël”</p> <p>Përralla: “Rosaku i shëmtuar”</p>	

MUAJI NËNTOR

Tema mujore: Njohja e vetes & Të drejtat e fëmijëve

Çfarë duhet të dimë për Nëntorin? Bebet e lindura në muajin nëntor mendohet të jenë sportistët e ardhshëm. Kjo falë vitaminës D që nëna ka marrë gjatë muajve të ngrohtë të verës. Më shumë rreze dielli, më shumë vitaminë D dhe kocka më të forta. Të lindurit në muajin nëntor nuk tremben lehtë dhe dinë si t'u bëjnë ballë situatave të ndryshme. Janë shumë të përgjegjshëm dhe duan të vendosin vetë për jetën e tyre. Gjithashtu mandarinat dhe portokallet ne nisim t'i shijojmë në nëntor.

1. **Java I:** Njohja e vetes
2. **Java II:** Identifikimi sipas gjinisë
3. **Java III:** Të drejtat e fëmijëve
4. **Java IV:** Njohja me festat dhe festimi i tyre

Tema mujore : Njohja e vetes & Të drejtat e fëmijëve		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Njohja e vetes	Njohja e vetes.	Java I
Identifikimi sipas gjinisë	Njohja me disa nga karakteristikat gjinore dhe veshjet për fëmijë.	Java II
Të drejtat e fëmijëve	Njohja me disa nga të drejtat kryesore. Konventa e fëmijëve.	Java III
Njohja me festat dhe festimi i tyre	Njohja me Festat e Nëntorit.	Java IV

Java I - Tema e javës: Njohja e vetes

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Fytyra ime	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon/pyet fëmijët mbi shqisat/tiparet e fytyrës. Ku është syri/hunda/goja/veshi etj? Ku e ke gojën... Lola...? Çfarë ngjyre i keni sytë? Vjersha: “Këtu jam unë” Loja: “Me pasqyrë” Vizatimi/Ngjyrosja: “Shprehi të fytyrës” – përmes vizatimit edukatorja të shpjegojë rreth gjëndjeve emocionale të fytyrës, p.sh. kur jemi të gëzuar – qeshim/të inatosur – rrudhim vetullat/kur çuditemi – hapim sytë dhe gojën.</p>	Mjete didaktike Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 7
E martë	Trupi im	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon /tregon/pyet fëmijët mbi pjesët e trupit. Ku është dora/këmba/barku etj? Ku e ke dorën... Lola...? Sa duar/gishta/këmbë kemi? (vijon dhe me numërimin e tyre). Vjersha: “Këtu jam unë” Kënga: “Këngë lëvizore” (1 ose 2) Vizatimi/Ngjyrosja: “Pjesët e trupit – Ngjyrosja e</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 8
		formave/modeleve nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët.	

E mërkurë	Ky në pasqyrë jam “Unë”!	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve mbi pasqyrën për të parë veten. Në pasqyrë shohim/dallojmë kokën/fytyrën/trupin. “Pasqyrë ...moj pasqyrë... ku është këmba/dora ime?”</p> <p>Loja: “Me pasqyrë”</p> <p>Loja: “Pikturimi me gishta” (bërja e gjurmëve të gishtave të dorës/këmbës).</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p> <p>Kënga: “Këngë lëvizore” (1 ose 2)</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 7
E enjte	Emri im!	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja fillimisht shpjegon që të gjithë njerëzit kanë një emër. Emri vendoset kur ne vijmë në jetë.</p> <p>Loja: “Si e kam emrin?” – Edukatorja pyet çdo fëmijë për emrin/nxit dialogun për mësimin e emrave të njëri-tjetrit. Mësimi i emrit të shokut/shoqes që luan më shumë.</p> <p>Kënga: “Këngë lëvizore”</p> <p>Loja: “Sylla-mbylla” (thërritet emri)</p> <p>Përrallë e lirë: Ilustrimi i figurave (sipas librave që disponojnë në grup)</p>	Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 8-9
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p> <p>Kënga: “Këngë lëvizore”</p> <p>Loja: “Si e kam emrin & Me pasqyrë”</p> <p>Krijimi: “Revista që tregon për mua” – grupimi i elementëve të fytyrës dhe trupit (ose foto personale të sjella nga shtëpia) që fëmija ka vizatuar gjatë javës. Vendosja e emrit mbi to.</p>	

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Unë jam Vajzë Unë jam Djalë	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve se kur vijmë në jetë jemi vajzë ose djalë. Edukatorja pyet fëmijët: Po ti çfarë je... vajzë apo djalë? Vjersha: “Çdonjëri prej nesh është i bukur” Lojë energjike: “Me top” Lojë: “Me kuba dhe blloqe ndërtimi”</p>	<p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 10-11</p>
E martë	Çfarë veshin fëmijët?	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon fëmijëve veshjet karakteristike si: pantallonat/bluzat/fundi/xhaketa/fustani/kapele/kordele koke/karfica etj. Edukatorja pyet: Çfarë ke veshur ti... Arba? Drini çfarë ka veshur Sidita? Po Joni? Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Çdonjëri prej nesh është i bukur” (me zgjedhje) Punim dore: “Veshjet në muajin Nëntor” (flete punëdore ose copa) Përrallë: “Hirushja/Borëbardha/ Frozen” (me zgjedhje)</p>	<p>Mjete didaktike</p>
E mërkurë	Çfarë veshin kukullat?	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u demonstron fëmijëve veshjet e kukullave që ndodhen në grup: këmisha, fustanet, kapelet, pantallonat, etj. Edukatorja pyet: Çfarë kanë kukullat? Vjersha: “Çdonjëri prej nesh është i bukur” Loja: “Kukulla që vishet” (vishen kukullat)</p>	<p>Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 9</p>
		<p>Vizatimi/Ngjyrosja: “Veshje për djemtë– ngjyrosja e formave/modeleve nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatoret. Përrallë: “Pinoku”</p>	

E enjte	Dëshirat e fëmijëve	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja pyet fëmijët: Çfarë dëshiron më shumë ti Arba? Po ti Drini? Çfarë lodre/lojë/libri pëlqen më shumë ti Arba? Po ti Joni?</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Gimi i vogël”</p> <p>Loja: “Mua më pëlqen... Po ty/asaj/atij?”</p> <p>Loja energjike: “Me litar” (ndarja në 2 grupe – vajza/djem)</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 8
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës. Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Çdonjëri prej nesh është i bukur/ Gimi i vogël”</p> <p>Loja: “Mua më pëlqen... Po ty/asaj/atij?”</p> <p>Loja energjike: “Me litar/Hedhja e topit në kosh/Me karrige”</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 8

Java III - Tema e javës: Të drejtat e fëmijëve

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me disa nga të drejta themelore të fëmijëve	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon/flet fëmijëve për disa nga të drejtat themelore të tyre: Ju keni të drejtë të keni një emër, një familje, të thoni mendimin dhe dëshirat tuaja, të mos ju fyejnë, etj (edukatorja mund të shprehë edhe të tjera nëse e sheh të nevojshme).</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Punëdore: “Pema e të drejtave” – përgatitja në forma të</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 10</p>
		<p>ndryshme sipas dëshirës.</p> <p>Lojra të lira: “Roza-rozina/Me kuba/Me blloqe” (të ndarë në grupe).</p>	

E martë	E drejta për të patur një emër	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve se kur lindim duhet që prindërit të na vënë një emër: Të gjithë fëmijët duhet të thirren në emrin që kanë!</p> <p>Loja: “Si e kam emrin?” – Edukatorja thërret çdo fëmijë në emër/nxit dialogun për mësimin e emrave të njëri-tjetrit.</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Punëdore: “Pema e të drejtave” – përgatitja në forma të ndryshme sipas dëshirës.</p> <p>Lojë: “Loja e telefonit” – improvizimi i komunikimit të fëmijëve me telefon duke thirrur emrat e njëri-tjetrit, p.sh: Alo Miri! Alo Ema!</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 9
E mërkurë	E drejta për të patur familje	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve rreth familjes.</p> <p>Ne kemi dy prindër, motër, vëlla, gjysh, gjyshe.</p> <p>Jo të gjitha familjet janë të njëjta për ng apërbërja port ë gjitha janë të ngrohta etj (edukatorja mund të shprehë të tjera ide nëse e sheh të nevojshme).</p> <p>Vjersha: “Familja”</p> <p>Vizatim/Ngjyrosje: “Familja ime” – vizatim i lirë dhe ngjyrosja e formave/modeleve të përgatitura më parë nga edukatorja.</p> <p>Ekspozitë: “Me foto familjare” – Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë foto.</p> <p>Përralla: “Mama dhia dhe kecat”</p>	
E enjte	E drejta për të	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon / tregon	Mjete didaktike

	luajtur	fëmijëve që secili ka dëshirë por edhe të drejtë të luajë. Fëmijët duhet të kenë lodra dhe hapësira për të luajtur si Brenda edhe jashtë (shtëpi, çerdhe, kopshte, etj). Edukatorja pyet: Çfarë loje të pëlqen më shumë? Çfarë lodre pëlqeni më shumë? Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve” Punëdore: “Pema e të drejtave” – përgatitja në forma të ndryshme sipas dëshirës. Loja: “Me kukulla/Me top/Me makina” (sipas dëshirës)	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 9
E premte	Festimi i Konventës së të Drejtave	Ekspozimi: “Pema e të drejtave” – në kënde të caktuara. Bisedë: Edukatore-fëmijë: Përsëritja e të drejtave të mësuara gjatë javës (referuar përmes së të drejtave). Aktivitet në grup: “Këngë, recitime, valle, etj”.	Mjete në grup

Java IV - Tema e javës: Të drejtat e fëmijëve			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me festat	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve për disa nga festat kryesore që festojmë si: ditëlindja, 1 Qershori, Viti i Ri, etj. Edukatorja shpjegon dhe pyet për ditëlindjen më të afërt të festuar prej fëmijëve ose festa të tjera. Vjersha: “Gëzuar ditëlindjen Elonë!”	Mjete didaktike Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 12-13

		<p>Këngë: “Bufi bëri dasëm” (të shpjegohet kuptimi i këngës)</p> <p>Loja: “Kartolina e festave”</p> <p>Përralla: “Hirushja”</p>	
E martë	Festimi i ditëlindjes	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve si mund të festohet një ditëlindje. Si vishemi... më bukur... Çfarë dhurate i bëjmë shokut/shoqes? Si e zbukurojmë ambientin?</p> <p>Vjersha: “Gëzuar ditëlindjen Elonë!”</p> <p>Këngë: “Kënga e ditëlindjes” (shumë urime për ty...)</p> <p>Punëdore: “Paketimi i dhuratës”</p> <p>Përralla: “Bardhoshja ka ditelindjen” (referuar teatrit)</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 10</p>
E mërkurë	Festat e Nëntorit	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja u shpjegon/tregon fëmijëve për Festat e Nëntorit (në terma shumë të thjeshta). Edukatorja i njuh fëmijët me flamurin/shpjegon ngjyrat kuq e zi.</p> <p>Vizatim/Ngjyrosje: “Flamuri” – ngjyrosja e formave/modeleve nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorja (theksohen ngjyrat).</p> <p>Punëdore: “Përgatitja e flamujve për festa” (shoqëruar me numërimin dhe njohja e konceptit: flamur i madh ose i vogël).</p> <p>Lojra energjike: “Me karrige / me shami”</p>	<p>Mjete didaktike</p>

E enjte	Zbukurimi i çerdhes për festa	<p>Aktivitet në grup: Edukatore – fëmijë bashkarisht zbukurojnë grupet me flamuj të përgatitur një ditë më parë, tollumbace dhe elementë të tjerë dekorativë që disponojnë (shoqëruar me shpjegim nga ana e edukatores, pyetje të thjeshta, theksohen ngjyrat, numërimi).</p> <p>Vjersha: “Flamuri”</p> <p>Këngë & kërcim: Këngët për flamurin”</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 11
		Loja: “Vizatimi dhe piktura”	
E premte	Festimi i Festave të Nëntorit	<p>Improvizim sfilate: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që fëmijët të vishen me veshje kuq e zi ose costume popullore. Përgatitja e një sfilate të thjeshtë në grup.</p> <p>Ekspozitë: “Elementët festiv” të cilat janë bërë gjatë javës. Demonstrimi i tyre.</p> <p>Përsëritja: Vjershat dhe këngët e javës.</p> <p>Aktivitet festiv në grup: “Këngë, recitime, valle për festa, etj.”</p>	

MUAJI DHJETOR

Tema mujore – Karakteristikat e stinës së dimrit

Çfarë duhet të dimë për DIMRIN: dimri është stina më e ftohtë e vitit. Në dimër temperatura është shumë e ulët, era e acartë dhe bie dëborë. Në dimër mbizotëron natyra me ngjyrë gri. Gjatë dimrit disa kafshë, si p.sh. ariu, iriqi, etj., bien në gjendje të thellë gjumi. Sipas studimeve, shumica e kafshëve në dimër ushqehen me sasi më të madhe ushqimi, për të ruajtur temperaturën e trupit.

1. **Java I:** Karakteristikat e përgjithshme të stinës së dimrit. Natyra në dimër dhe veshjet e saj.
2. **Java II:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së dimrit.
3. **Java III:** Përgatitja për festën e Vitit të Ri. Elementët matematikor përmes elementëve dekorues.
4. **Java IV:** Programi festiv i Vitit të Ri.

Tema mujore : Njohja e vetes & Të drejtat e fëmijëve		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Njohja me karakteristikat kryesore të dimrit/ i ftohti/ bora. Veshjet tipike të fëmijëve për stinën e dimrit.	Njohja me elementët kryesorë të dimrit, si : moti shumë i ftohtë, era e fortë, bora, etj. Si të vishemi në dimër. Ndryshimi i veshjes sipas stinës.	Java I
Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së dimrit.	Njohja e frutave, perimeve përmes demonstrimit të përgatitjes së ushqimeve.	Java II
Përgatitja për festën e Vitit të Ri. Elementët dekorues. Format, ngjyrat, numërimi i tyre.	Njohja me elementët kryesor dekorues të festës së Vitit të Ri, babagjyshi i Vitit të Ri, bredhi e dhuratat, etj. Format, përmasat, ngjyrat dhe numërimi i tyre.	Java III
Programi festiv i Vitit të Ri.	Vjersha dhe këngë festive.	Java IV

Java I - Tema e javës: Njohja me karakteristikat e përgjithshme të stinës së dimrit

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Natyra në dimër	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë : Në stinën e dimrit bën shumë ftohtë. Bie borë dhe pemët, rrugët zbardhen. Nga i ftohti pemët janë krejt të zhveshura dhe qielli, shpesh, është gri.</p> <p>Aktivitet (i orientuar): Vrojtjmë nga dritarja motin në dimër (shoqëruar me emërtimin e elementëve natyrorë) si: retë, era, shiu dhe bora.</p>	<p>Libri i vjershave Libri i lojërave</p>
		<p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”</p> <p>Lojra: “Imitimi i lojës me topa bore” (Edukatorja përdor topa lodre prej letre, bukëpeshku, etj.)</p> <p>Punim në vazhdimësi gjatë muajit: “Njeriu prej bore” – edukatoret mund të krijojnë një të tillë që mund të shërbejë si dekor jo vetëm për stinën e dimrit, por edhe si element dekorues për fundvitin.</p>	

E martë	Njeriu prej dëbore	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve rreth dëborës, ngjyrës së saj, ku dhe kur bie më shumë. A e keni parë borën? A keni luajtur ndonjëherë me të? A keni qenë në Dajt me prindërit kur ka rënë dëborë? Me borën ne luajmë, bëjmë njeri prej bore etj.</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”</p> <p>Vizatim: “Njeriu prej bore”</p> <p>Aktivitet krijues: Me degëza të mbledhur jashtë bashkë me fëmijët (24-36 muaj) edukatoret mund t’i veshin me pambuk, letra të bardha, kartopeceta për të dhënë idenë e borës. Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 12
E mërkurë	Veshja e fëmijëve në dimër	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon / pyet fëmijët: Si vishemi në dimër? Edukatorja shpjegon, që për shkak të të ftohtit në dimër veshim rroba të trasha si pallto, shall, kapuç, doreza. Këto rroba na mbrojnë nga i ftohti, shiu, era e ftohtë e dimrit.</p> <p>Loja: “Veshja”</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”</p> <p>Punëdore: “Veshjet e fëmijëve në stinën e dimrit” – ngjyrosja nga fëmijët e formave të përgatitura më parë nga edukatoret</p>	Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 14-15
		(fletë punë dore ose copa). Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”.	

E enjte	Veshja e kukullës	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon/pyet: Si e veshim kukullën në dimër? Cilat janë veshjet e duhura?</p> <p>Aktivitet i orientuar: Edukatorja bashkë me fëmijët demonstrojnë veshjen me elementët dimërorë, si shalli, dorezat, kapelet, kapuçi, papuçet. Vjersha: “Bora e bardhë”</p> <p>Vizatimi/Ngjyrosja: Ngjitja e veshjeve dimërore tek modelet e përgatitura më parë nga edukatorja.</p> <p>Lojra: “Imituese” Fëmijët veshin kukullën.</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 10
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	<p>Bisedë: Përsëritja mbio elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”</p> <p>Përrallë e lirë: Ilustrim i figurave sipas librave që disponojnë në grup.</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 11

Java II - Tema e javës: Frutat dhe perimet e stinës			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me frutat	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve/tregon/demonstron përmes formave plastike, tablove, librave, revistave frutat e stinës si: molla, portokalli, mandarinat, gështenjat, etj. Cilat fruta pëlqeni?</p> <p>Vjersha: “Etika e ushqimit”</p> <p>Loja: “Tabela e lotos” (specifikisht me figura frutash)</p>	

		Vizatimi/Ngjyrosja: “Frutat e stinës” (Portokalli ose molla) - ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatoret (shoqëruar me numërimin e tyre dhe përcaktimin e ngjyrës).	
E martë	Njohja me perimet	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve/tregon/demonstron përmes formave plastike, tablove, librave, revistave perimet e stinës, si: lulalakra, brokoli, fasulet, thjerrëzat, spinaqi, karrotat, rrepkat, etj. Vjersha: “Etika e ushqimit” Loja: “Tabela e lotos” (specifikisht me figura perimesh). Vizatimi/Ngjyrosja: “Perimet – ngjyrosja nga fëmijët e formave të përgatitura më parë nga edukatoret, si: karrotat, panxhari, brokoli, etj. (shoqëruar me numërimin e tyre).	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 12
E mërkurë	Përgatitja e ushqimeve (Përgatitja e supës në shtëpi dhe çerdhe, si ushqim i ngrohtë që preferohet nga fëmijët)	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon/pyet fëmijët si e gatuan supën mami në shtëpi. Shpjegohet përgatitja e supës me perimet e stinës. Vizitë: Në kuzhinë (24-36 muaj). Teta kuzhinierja shpjegon çfarë ushqimesh ka përgatitur për atë ditë ose shpjegon rreth përgatitjes së supës. Edukatorja shpjegon vlerat që ka supa për shëndetin e fëmijëve. Loja: “Fruta dhe perimet/Bëj sikur gatuan” (me zgjedhje). Përralla: “Rrepka”	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 13
E enjte	Punë dore të frutave dhe perimeve të stinës së dimrit	Punë dore (me plastelinë): “Të krijojmë fruta dhe perime të stinës së dimrit” Përralla: “Kësulëkuqja” Edukatorja nxit fëmijët të mbushin shportën me fruta të stinës.	Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 16-17

E premte	1.Panairi i frutave dhe perimeve të stinës së dimrit. 2.(ose) Të pimë një çaj ose lëng të ngrohtë me fruta të stinës së bashku	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon/pyet: Cilat janë frutat dhe perimet e stinës? Çfarë ngjyre kanë ato? Aktivitet: Fëmijëve iu shpjegohet që përdorimi i lëngjeve të ngrohtat për stinën e dimrit ndihmon për të na mbrojtur nga i ftohti dhe gripi. A ktivitetet që mund të relizohen: *Mund të improvizohet, ose edhe të përgatitet realisht nga kuzhina çaji dhe mund të serviret në grup. *Mund të improvizohet përgatitja e një lëngu me fruta të stinës nga edukatoret dhe kuzhinierja. Panairi i frutave dhe perimeve: Edukatoret të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë fruta dhe perime të stinës ose ëmbëlsira të përgatitura me fruta të stinës së dimrit (demonstrimi realizohet me konceptin e ngjyrës dhe numërimi sipas kategorisë fruta/perime).	
-----------------	---	---	--

Java III - Tema e javës: Përgatitja për festën e Vitit të Ri. Elementët dekorues. Format, ngjyrat, numërimi i tyre.

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me elementët dekorues të festës së Vitit të Ri	Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve: Dhjetori është muaji i fundit i vitit. Këtë muaj festojmë ardhjen e Vitit të Ri. Edukatorja pyet: Çfarë feste po afron? A e keni parë ndonjëherë babagyshin e Vitit të Ri? Vizatimi/Ngjyrosja: Ngjyrosja e babagyshit të Vitit të Ri nga fëmijët, e përgatitur më parë nga edukatoret. Vjersha: “7 dhuratat” Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”	Mjete didaktike

<p>E martë</p>	<p>Bredhi i Vitit të Ri</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se do të zbukurojnë bredhin. A e keni zbukuruar bredhin në shtëpi? Edukatorja iu shpjegon fëmijëve ngjyrën e elementëve dekorues duke realizuar dhe numërimin e tyre: Çfarë ngjyre ka ylli, topi, etj.? Ejani t’i numërojmë së bashku! Sa topa me ngjyrë të kuqe ka në tavolinë? (1, 2, 3, 4, 5). Aktivitet i lirë: Fëmijët së bashku me edukatoren zbukurojnë bredhin duke vendosur elementët dekorues festivë. Loja: “Zarfa me forma dhe numra”. Format gjeometrike. Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”</p>	<p>Mjete didaktike Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 13</p>
<p>E mërkurë</p>	<p>Përgatitja e dhuratave</p>	<p>Aktivitet i orientuar: Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin dhurata: Kuti të gatshme me përmasa të ndryshme i veshim me një paketim festiv. (Përdorim letra të shndritshme dhe me ngjyra të ndryshme). Vjersha: “7 dhuratat” Kënga: “Jan a erdhi Viti i Ri”</p>	<p>Mjete didaktike Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 11</p>
<p>E enjte</p>	<p>Përgatitja e kapeleve të Vitit të Ri</p>	<p>Aktivitet: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë kapele festive për Vitin e Ri për fëmijën e tyre. Edukatorja demonstron dhe së bashku me fëmijët përgatit një kapele. Vizatim/Ngjyrosje: Fëmijët së bashku me edukatoren ngjyrosin kapelën prej kartoni dhe vizatojnë/ngjisin një ose disa elemente festivë. Vjersha: “7 dhuratat” Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri” fëmijët këndojnë së bashku.</p>	<p>Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 14</p>
<p>E premte</p>	<p>Përgatitja e kartolinave të urimit</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se do të përgatisin së bashku kartolinat për Vitin e Ri. A keni parë më parë kartolinë për Vitin e Ri? Edukatorja demonstron një</p>	<p>Mjete didaktike</p>

		<p>kartolinë. A e dini se cili është urimi në të?</p> <p>Aktivitet i orientuar: Fëmijët së bashku me edukatoren ngjyrosin kartolinën dhe vizatojnë/ngjisin një ose disa elementë festivë.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri” fëmijët këndojnë së bashku.</p>	
--	--	---	--

Java IV - Tema e javës: Programi festiv i Vitit të Ri			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Dekorimi i ambjenteve në grupe	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se festa po afron dhe të gjithë së bashku do të festojnë me vjersha dhe këngë Vitin e Ri. Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin vargje me punë dore për zbukurimin e ambjentit në grup, vendosin pambuk në dritare ose pemë të përgatitura me punë dore.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”</p> <p>Vjersha: “ Bora e bardhë”</p> <p>Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”</p> <p>Vjersha/këngë: Të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 14
E martë	Përgatitja e vjershave/këngëve	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 12

		Vjersha: “ Bora e bardhë” Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu” Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri” Vjersha/këngë: Të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.	
E mërkurë	Përgatitja e vjershave/këngëve	Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv. Vjersha: “7 dhuratat” Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit” Vjersha: “ Bora e bardhë” Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu” Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri” Vjersha/këngë: Të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 15
E enjte	Përgatitja e vjershave/këngëve	Përsëritje e programit festiv Bisedë me prindërit: -Veshja festive e fëmijëve për festën e Vitit të Ri (përgatitje për festën e ditës së nesërme). -Dhurata që prindi dëshiron të sjellë për fëmijën e tij. -Pjesëmarrja e prindërve me dëshirë në festë.	
E premte	Festa e Vitit të Ri	Realizimi i programit festiv. Shpërndarja e dhuratave.	

MUAJI JANAR

Tema mujore – Familja dhe profesionet

Çfarë duhet të dimë për muajin JANAR?

JANARI është muaji i parë i vitit dhe muaji i dytë i stinës së dimrit. Ky muaj nis me pushimet e Vitit të Ri dhe me festimet përkatëse. Në këtë muaj duhet të konsumojmë frutat dhe perimet e stinës, veçanërisht frutat e thata si: lajthitë, bajamet dhe arrat.

1. **Java I:** Familja, anëtarët dhe shtëpia jonë.
2. **Java II:** Profesionet e prindërve dhe të stafit në çerdhe.
3. **Java III:** Profesionet e edukimit dhe të artit.
4. **Java IV:** Profesionet e shërbimit.

Tema mujore : Familja dhe profesionet		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Anëtarët e familjes, fisi dhe marrëdhëniet midis tyre.	Të njohim familjen dhe anëtarët e saj.	Java I
Profesionet e familjes dhe të stafit të çerdhes.	Të njohim fëmijët me profesionet e familjes dhe të stafit eduk. ator.	Java II
Profesionet e edukimit dhe artit: mësuesja, piktori, aktori dhe këngëtari.	Të njohim fëmijët me profesionet e edukimit dhe të artit: mësuesja, piktori, këngëtari dhe aktori.	Java III
Profesionet e shërbimit: shitësja, parukierja, zjarrfikësi, polici, elektrikësi, hidrauliku dhe muratori.	Të njohim fëmijët me profesionet e shërbimit si: shitësja, parukierja, zjarrfikësi, polici, elektrikësi, hidrauliku, muratori.	Java IV

Java I - Tema e javës: Anëtarët e familjes, fisi dhe marrëdhëniet midis tyre

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Familja ime	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve konceptin e familjes dhe pyet: Sa anëtarë jeni ju në familjen tuaj? A keni vëlla / motër? A keni gjysh / gjyshe? Edukatorja tregon foto të familjeve të fëmijëve të sjella më parë nga prindërit. Lojë imituese: “Shtëpiash” – Edukatorja të orientojë fëmijët në imitim e roleve në familjet e tyre. Vjersha: “Familja”</p> <p>Përrallë: “Mama dhia dhe shtatë kecat”</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 13</p>
E martë	Puna në familje dhe rolet	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve disa nga punët/aktivitetet që mund të bëjnë anëtarët e familjes në shtëpi si p.sh. mami merret me pastrimin, sistemon shtëpinë/babi bën pazarin apo ndihmon me gatimin/gjyshja mund të bëjë gjellën, të ujisë lulet/gjyshi lustron këpucët, etj.</p> <p>Edukatore – fëmijë: Edukatorja pyet: Kush gaton dhe pastron në familjen tuaj? A e ndihmon babi mamin? Si e ndihmon ai atë? Po gjyshi, gjyshja çfarë pune kryejnë në shtëpi? Edukatorja shpjegon rëndësinë e ndihmës në shtëpi dhe ndaj prindërve.</p> <p>Vjersha: “Babi im”</p> <p>Vizatimi/Ngjyrosja: “Shtëpia ime” – Edukatorja ndihmon fëmijët të kuptojnë dhe përdorin format gjeometrike për të ndërtuar një shtëpi. Vjersha: “Familja”</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 15</p>

E mërkurë	Shtëpia ime	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja pyet fëmijët nëse jetojnë në një shtëpi apo në apartament në pallat. Edukatorja pyet fëmijët për sendet që kanë në dhomat e tyre të ndenjes dhe të gjumit.</p> <p>Aktivitet edukues: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rregullat në shtëpi, si p.sh.: bëme kujdes kur ecim në banjë, nuk prekim prizat, nuk prekim sendet e nxehta, etj.</p> <p>Pune dore me plastelinë (ose punë dore ngjitje me letra me ngjyra): “Shtëpia ime” Vjersha: “Familja”</p>	<p>Mjete didaktike: plastelinë, Letra me ngjyra</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 16</p>
E enjte	Argëtim me familjen	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja pyet: A dilni shëtitje me prindërit? A keni luajtur në kënde lojrash? A luani me shokë/shoqe?</p> <p>Vjersha: “Familja”</p> <p>Aktivitet edukues: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rregullat në çerdhe, si p.sh; bëjmë kujdes kur ecim në banjë, nuk vrapojmë me shpejtësi të madhe në grup, nuk prekim prizat, nuk prekim sendet e nxehta, etj.</p> <p>Ngjyrosje: Lodra, sende shtëpiake, etj. (sipas modeleve të realizuara më parë nga edukatorja). Përralla: “Pikniku i Arushit Ted”</p>	Modelet për ngjyrosje
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	<p>Bisedë: Përsëritja e temave/vjershave të mësuara gjatë javës.</p> <p>Ekspozitë me foto familjare: Albumi i familjes time. (Prindërit sjellin një album me fotot).</p> <p>Aktivitet: Improvizimi i një pikniku me familjen (Edukatorja diskuton për sendet dhe ushqimet e nevojshme që duhen për të organizuar një piknik).</p>	Mjete didaktike

		Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj.	
--	--	--	--

Java II - Tema e javës: Profesionet e familjes dhe profesionet e stafit në çerdhe			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me profesionin e prindërve	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja pyet: Çfarë pune bën mami? Çfarë pune bën babi? (grupmosha 24-36 muaj). Sipas dëshirës mund të jetë present një prind fëmije që të prezantojë profesionin e vet.</p> <p>Aktivitet i orientuar: Fëmijët sipas dëshirës mund të luajnë në profesionet e përmendura më sipër (profesionet e prindërve) ose një profesion tjetër që e zgjedhin ata vetë. Fëmijët me ndihmën e edukatores demonstronë në grup profesionin që duan të imitojnë. Edukatorja ndihmon fëmijët të gjejnë mjetet që përdoren për profesionet e zgjedhura. (Edukatorja mund të përdorë ilustrimin në këtë material për profesionet e përmendura nga fëmijët)</p> <p>Vjersha: “Babi im”</p> <p>Vjersha: “Kur shkon mami për në punë”</p> <p>Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 14</p>
E martë	Njohja me rolin e gjyshit/gjyshes	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve p.sh.: gjyshërit falin dashuri/kujdesen për fëmijët/i përcjellin e i marrin nga çerdhja/i shoqërojnë fëmijët në shëtitje dhe në këndet e lojrave/iu tregojnë përralla, etj.</p> <p>Kënga: “Tregon gjyshja”</p> <p>Aktivitet i improvizuar: Një edukatore vishet si gjyshe dhe</p>	<p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 18-19</p>

		tregon një përrallë (edukatorja vesh një triko të madhe, vë një palë size, ecën me ngadalë, etj). Vjersha: “Gjyshi i bie legenit” Vjersha: “Gjyshja ime aq e mirë”	
E mërkurë	Njohja me profesionin e edukatores	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rreth profesionit të saj. (Përkujdesjen fizike dhe edukimin e fëmijëve bazuar në programin edukativ). Lojë imituese: “Bëj sikur” (profesioni i edukatores). Punë dore/plastelinë: “Një buqetë me lule” Vjersha: “Edukatores” Kënga: “Tregon gjyshja” Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, eyj.	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 17
E enjte	Njohja me profesionin e kuzhinieres	Vjersha: “Edukatores” Kënga: “Tregon gjyshja” Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon rolin e kuzhinieres. Ajo pyet fëmijët: Kush gatuan në çerdhe? Vizitë: Në kuzhinë (24-36 muaj) – shpjegon edhe teta kuzhinierja çfarë ushqimesh ka përgatitur për atë ditë. Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin modele ushqimesh (një pjatë me supë, një fetë torte, disa fruta, etj) dhe enët e kuzhinës, të gatimit dhe mjetet që përdorim për të ngrënë, të përgatitura më parë nga edukatorët. Përrallë: “Byreku i mbretit”	Modelet për ngjyrosje Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 16
E premte	Njohja me profesionin e mjekes	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon profesionin e mjekes duke iu shfaqur paisjet e zakonshme të saj (lodra) /	Modelet për ngjyrosje

		ilustrimet përkatëse. A jeni vizituar ndonjëherë të mjekja? Kur vizitohemi te mjekja? Mjekja e çerdhes shpjegon profesionin e	
		saj. (Ditët e kësaj jave mund të kombinohen edhe në varësi të grafikut të mjekes së çerdhes). Loja imituese: “Bëj sikur” (profesioni i mjekut). Udhëheq edukatorja e grupit. Vjersha: “Mikrobet” Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj.	

Java III - Tema e javës: Profesionet e edukimit dhe të arteve: mësues, piktor, këngëtar dhe aktor

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me profesionin e mësuesit	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve profesionin e mësuesve në shkollë dhe rolin e tyre në edukimin e fëmijëve. Loja imituese: “Bëj sikur” (profesioni i mësueses) Udhëheq edukatorja e grupit. Fëmijët identifikojnë mjetet shkollore. Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin mjetet shkollore (lapsa, çantë, libër, vizore, dosje, etj) të përgatitura më parë nga edukatorja. Përrallë e lirë: Sipas librave që disponojnë në grup.	Modelet për ngjyrosje Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 18

E martë	Njohja me profesionin e piktorit	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve profesionin e piktorit. (Duke prezantuar vizatime të ndryhme të ilustruara nëpërmjet librave, revistave, përrallave që disponojnë në grup). Fëmijët së bashku me edukatoren identifikojnë mjetet që përdor piktori (penel, bojra, telajo, etj).</p> <p>Kënga: “Qengji i vogël”</p> <p>Vizatim i lirë</p> <p>Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj,</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 20-21
E mërkurë	Njohja me profesionin e këngëtarit	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve profesionin e këngëtarit. (Duke prezantuar këngë që disponojnë nga programi i edukimit).</p> <p>Lojë imituese: “Bëj sikur” (profesioni i këngëtarit). Udhëheq edukatorja e grupit. Fëmijët përsërisin këngë të mësuara më parë duke luajtur rolin e këngëtarëve.</p> <p>Kënga: “Qengji i vogël”</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin mjetet që përdorin këngëtarët dhe piktorët si: mikrofon, radio, penela, etj. (modele të përgatitura më parë nga edukatorja). Përrallë: “Fuqia e këngës”</p>	Modele për ngjyrosje

E enjte	Njohja me profesionin e aktorit Kllouni me plastelinë	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon fëmijëve profesionin e aktorit (Duke prezantuar rolet e realizuara deri tani nëpërmjet imitimeve të profesioneve të ndryshme). Kënga: “Qengji i vogël” Punë dore me plastelinë: “Kllouni me plastelinë”. Fëmijët nëpërmjet plastelinës mësojnë dhe përsërisin format. Me ndihmën e edukatores ata ndërtojnë forma gjeometrike me plastelinë dhe i ngjisin sis y (katrorët, rrethorët), gojë (rrethorët), hundë (drejtkëndësh, rrethor), kapele (trekëndësh) për të ndërtuar portretin e kllounit. Përrallë: “Pirueta e Gluglusë”	Mjete didaktike
E premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu ripërsërit profesionet e mësuara gjatë javës. Kënga: “Qengji i vogël” Filmi vizatimor: “Arushi kërkon babanë”. Edukatorja iu shpjegon profesionet e përmendura dhe fabulën e filmit.	Mjete didaktike Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 17
		Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj.	

Java IV - Tema e javës: Profesionet e shërbimit: shitësja, parukierja, zjarrfikësi, polici, hidrauliku, elektrikisti, muratori

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
------------------	--------------------	---	---

<p>E hënë</p>	<p>Njohja me profesionin e shitëses Njohja me profesionin e parukieres</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon profesionin e shitëses, e cila iu shërben njerëzve. Shitëset i gjejmë në dyqane/supermarket, kur blejmë libra/lodra, kur blejmë bileta për teatër/kinema, kur blejmë veshje, et. Edukatorja pyet fëmijët: Ku e keni parë ju vetë shitësen? Lojë imituese: “Loja e dyqanit” Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon profesionin e parukieres, e cila iu shërben njerëzve për t’u zbukuruar. Fëmijët me ndihmën e edukatores identifikojnë mjetet që përdor parukierja. Lojë imituese: Fëmijët imitojnë krehjen e flokëve. Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj.</p>	<p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 15</p>
<p>E martë</p>	<p>Njohja me profesionin e zjarrfikësit</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon profesionin e zjarrfikësit duke e demonstruar me lodrën (një zjarrfikëse lodër), ilustrimin e këtij materiali. Ajo iu shpjegon fëmijëve se zjarrfikësi ndihmon në shuarjen e zjarreve, në shpëtimin e njerëzve duke i nxjerrë nga ndërtesa, etj. Pyet fëmijët: A keni parë ndonjëherë zjarrfikëse? Çfarë bën zjarrfikësi? Fëmijët përmendin mjetet e zjarrfikësit. Loja imituese: “Bëj sikur” (profesioni i zjarrfikësit). Udhëheq edukatorja e grupit.</p>	<p>Mjete didaktike për ngjyrosje Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 19</p>
		<p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin uniformën e një zjarrfikësi. (Edukatoret mund të përdorin ilustrimin në këtë material). Lojë: Lojë energjike: me top, me karrige, etj.</p>	

E mërkurë	Nohja me profesionin e policëve	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu demonstron fëmijëve ilustrime, foto dhe i pyet: Ku i keni parë policët? Çfarë bëjnë ata? Edukatorja iu shpjegon fëmijëve që policët ndihmojnë njerëzit të luftojnë keqberësit, të parandalojnë veprime që iu shkaktajnë dhimbje njerëzve, ndihmojnë trafikun dhe njerëzit të kalojnë në vija të bardha, ndihmojnë fëmijët kur ata mund të humbasin prindërit ose kur fëmijët ndjehen keq prej të rriturve keqberës.</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin uniformën e policit.</p> <p>Aktivitet alternativ: Përgjegjësja e çerdhes kontakton policin (të plotfuqishmin) e zonës për të ardhur në çerdhe dhe pët të folur për rolin e policisë së shtetit.</p> <p>Përrallë e lirë: Sipas librave që disponohen në grup.</p>	Mjete didaktike për ngjyrosje Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 18
E enjte	Njohja me profesionin e elektrikistit, hidraulikut dhe muratorit	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu shpjegon profesionin e elektrikistit, hidraulikut, muratorit dhe e demonstron përmes ilustrimeve të ndryshme. Kush kujdeset që të kemi githmonë drita në shtëpi? Po për ujin? Po në çerdhen tonë? E keni parë ndonjëherë hidraulikun ose elektrikistin?</p> <p>Lojë me kuba: Ndërtimi me kuba i një shtëpie.</p> <p>Vjersha: “Babi i është murator”</p> <p>Përrallë e lirë: Sipas librave që disponohen në grup.</p> <p>Lojë: Lojë e lirë me lodra, me kukulla, me kuba, etj.</p>	Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 22-23
E premte	Panairi i profesioneve	Aktivitet: Panairi i profesioneve. Fëmijët zgjedhin një nga profesionet e muajit (ose ndonjë tjetër nëse kanë dëshirë) dhe me ndihmën e prindërve (për veshjen, uniformën, mjetet e	Mjete didaktike

		profesionit të zgjedhur) dhe ndihmën e edukatores ata imitojnë profesionin e zgjedhur. Edukatorja kujdeset që të gjitha profesionet e muajit të përfshihen në panair. Ekspozitë: Fëmijët shfaqin figurat e ngjyrosura gjatë javës. Lojë: Lojë energjike: me top, me birila, me karrige, etj.	
--	--	--	--

MUAJI SHKURT

Tema mujore – Përrallat dhe personazhet e tyre

Çfarë duhet të dimë për muajin SHKURT? Shkurti është muaji i fundit i stinës së dimrit dhe muaji i dytë i vitit. Muaji Shkurt quhet i tillë, sepse është muaji me më pak ditë i vitit. Muaji Shkurt ka 28 ditë dhe një herë në katër vjet ka 29 ditë. Viti kur muaji Shkurt ka 29 ditë quhet “Viti i Brishtë”. Në muajin shkurt fillojnë të çelin lulet e para të pranverës si: lule mimoza, manushaqja, lulja e qershisë, etj.

1. **Java I:** Bota e përrallave
2. **Java II:** Personazhet më të dashur të përrallave
3. **Java III:** Bota e kafshëve përmes përrallave
4. **Java IV:** Teatri i kukullave

Tema mujore : Përrallat dhe personazhet e tyre		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Bota e përrallave	Njohja me botën e përrallave. Libri / Personazhet kryesorë të tyre.	Java I

Personazhet më të dashur të përrallave	Përrallat klasike / shqiptare / të reja. Emocionet në përralla / Veshja e personazheve.	Java II
Bota e kafshëve përmes përrallave	Njohja e kafshëve përmes përrallave: kafshët shtëpiake, kafshët e pyllit, bota ujore dhe e insekteve.	Java III
Teatri i kukullave	Njohja me teatrin e kukullave, përgatitja e një shfaqjeje teatrale në çerdhe.	Java IV

Java I - Tema e javës: Bota e përrallave			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me botën e përrallave	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja flet / iu shpjegon fëmijëve përrallat / ku i lexojmë (libra, revista) / që mund ti shikojmë në tv (filma vizatimorë). Ajo iu shpjegon fëmijëve se përrallat kanë Brenda fantazi (kafshët flasin, njerëzit mund të fluturojnë), por ato na mësojnë, na edukojnë dhe na kënaqin.</p> <p>Vjersha: “Milingona”</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i një pazëlli me figurat e një libri/reviste me përralla. Formoni pazëllin e kërkuar bashkë me fëmijët dhe tregoni përrallën me fjalët tuaja (zgjedhja e përrallës lihet e lirë).</p> <p>Kënga: “Kokëkashta”</p> <p>Loja energjike: Tuneli / loja Brenda dhe jashtë.</p>	Mjete didaktike: Libra, revista me përralla, pazëll Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 20

E martë	Personazhet e përrallave	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet fëmijëve mbi personazhet më të njohura të përrallave si: Kësulkuqja,	Mjete didaktike: fletë me personazhet e përrallave, lapsa
		Derrkucët, Çufo, etj. Përralla: “Uini Puh” Aktiviteti: Ngjitja në fletë/dritare e personazheve të preferuar të përrallave. Vjersha: “Milingona” Kënga: “Kokëkashta” Loja: Ndërtime me blloqe dhe kuba/futja e kubave në shishe duke i ndarë sipas ngjyrave.	me ngjyra, etj. Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 19
E mërkurë	Gjumi dhe përrallat	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve përse/ku/kur flemë gjumë. Pyet fëmijët se çfarë përralle iu tregojnë prindërit ose gjyshërit para se të flenë gjumë? Përralla: “Flokëarta dhe tre arinjte” Aktiviteti: Vendosja e kukullës në gjumë. Vjersha: “Nina nana kukulla/Bubi i vogël”. Vjersha shoqëron vënien e kukullës në gjumë. Loja: Loja me mjete të riciklueshme.	Kukulla, arusha Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 24
E enjte	Librat	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve çfarë është libri/ku i gjejmë librat (në librari, në bibliotekë, në panairin e librit)/librat na ndihmojnë të mësojmë fjalë të reja, të flasim bukur, etj. Vjersha: “Librat rrinë rradhë-rradhë” Përralla: “Reno kërmilli” Kënga: “Kokëkashta” Loja: Muzikë dhe kërcime.	Mjete didaktike: kartona, letra me ngjyra, fije, spango, ngjitës, revista ose gazeta për fëmijë. Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 16

E premte	Emocionet në përralla	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve katër emocionet bazë: i/e gëzuar, i/e habitur, i/e mërziur, i/e zemëruar. Zbulojmë së bashku këto emocione në përrallaën	Mjete didaktike: libra, revista, tollumbace, etj.
		<p>“Rosaku i shëmtuar”</p> <p>Përralla: “Rosaku i shëmtuar”</p> <p>Aktivitet: Imitimi i emocioneve me fytyrë improvizuar nga edukatorët. Edukatorja ndihmon fëmijët të imitojnë emocionet që ajo demonstron. Kënga: Kënga lëvizore</p> <p>Vjersha: “Tana dhe topi”</p> <p>Loja: Lojra të lira me tullumbace (loja me frymë, passim, etj).</p>	

Java II - Tema e javës: Personazhet më të dashur të përrallave			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike

<p>E hënë</p>	<p>Përrallat klasike</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve mbi personazhet kryesorë të përrallave klasike dhe mesazhet që ato përcjellin si: Mamadhia dhe shtatë kecat, Kësulkuqja, Rosaku i shëmtuar, etj.</p> <p>Përralla: Leximi ose shikimi i përrallës “Pinoku” në projektor/pc (teatri i kukullave). Pas shikimit të përrallës edukatorja i rendit gabimet e Pinokut (Pinoku gënjeu babanë, u largua pa leje, u shoqërua me të panjohur). Ajo ndihmon fëmijët të kuptojnë pse Pinokut iu rrit hunda dhe pse nuk duhet të gënjejnë asnjëherë. Aktiviteti: Fëmijët me ndihmën e edukatores Ndërtojnë Pinokun përmes formave gjeometrike me plastelinë, tapave të shisheve, etj. Fëmijët identifikojnë format gjeometrike. Vjersha: “Dëshirat e Pinokut / Kënga e Pinokut” Loja: “ Gjigandi, shkurtabiqi”</p>	<p>Mjete didaktike: letra me ngjyra, ngjitës, vizore, tapa druri, stika dhëmbësh, bojra ose plastelinë.</p>
<p>E martë</p>	<p>Përrallat e reja</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve mbi përrallat e reja si: Spiderman, Ana/Elsa, etj.</p> <p>Përralla: “Masha dhe ariu”/“Princi i qepëve dhe princesha e luleve”</p> <p>Aktivitet: Ngjyrosja, prerja dhe ngjitja e personazheve në këndin e personazheve/poster.</p> <p>Vjersha: “Dëshirat e Pinokut/Kënga e Pinokut” Loja: Topi në kosh, pasimi, shënjestra e tabelës me top.</p>	<p>Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fleta, top, etj.</p> <p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 25</p>

E mërkurë	Përrallat shqiptare: përrallat me kafshë	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve mbi përrallat shqiptare (kryesisht ato me kafshë), mesazhin që përcjellin, personazhet kryesorë të tyre si: Çufo, Bubi kaçurrel, Kokëkashta, etj.</p> <p>Përralla: “Ndodhitë e Çufos” “Pushimet e Çufos” “Çufo dhe bubi kaçurrel”</p> <p>Vjersha: “Tullumbacet”</p> <p>Aktivitet: Vizatim/ngjyrosje e personazhit të Çufos.</p> <p>Loja: Të luajmë tenis me tullumbace. Vendosini fëmijët dy e nga dy përballë njëri – tjetrit, jepini atyre nga një raketë tenisi. Nëse nuk keni përdorni pjata plastike apo karton në vend të raketës. Jepini fëmijës nga një tullumbac, lërini të lirë të zgjedhin ngjyrën që ata dëshirojnë. Ndihmojini fëmijët të gjuajnë tullumbacin me raketë.</p>	Mjete didaktike: tullumbace, raketa tenisi, pjata plastike, karton. Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 20
E enjte	Përrallat shqiptare: përrallat me personazhe	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet / shpjegon fëmijëve mbi përrallat shqiptare (kryesisht ato me njerëz) si: “Pipiruku”, “Fatbardh pikaloshi”, mesazhet që përcjellin, personazhet kryesorë të tyre.</p> <p>Aktivitet: Shikimi në pc/projector i përrallës “Pipiruku”</p>	Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, plastelinë. Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 17
		<p>Kënga: “Pipiruku”</p> <p>Vjersha: “Milingona”</p> <p>Aktiviteti 1: Bëjnë me plastelinë personazhin e milingonës.</p> <p>Aktiviteti 2: Lëvizje ritmike, kënga e “Pipirukut” (fëmijët imitojnë lëvizjet e edukatores).</p>	

E premte	Parada me veshjet e personazheve të përrallave	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet fëmijëve mbi veshjet e personazheve të ndryshëm të përrallave duke i demonstruar ato me figura. Pyetetn fëmijët: Çfarë kanë veshur personazhet? Çfarë ngjyrash kanë veshjet? Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë ngjyrat e veshjeve.</p> <p>Përralla: “Arushi që kërkonte babanë” (Edukatorja drejton fëmijët të kuptojnë se nuk largohemi pa lejen e të rriturve për të mos humbur si arushi).</p> <p>Përralla: “Gjithnjë e më lart”</p> <p>Punë dore: Edukatores paraprakisht krijojnë disa maska për fëmijët / ose u kërkojnë prindërve të sjellin disa maska në çerdhe. Fëmijët “bëjnë sikur” imitojnë personazhin e maskes që kanë vendosur.</p>	Mjete didaktike: karton, ngjyra, plastelinë. Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 21
-----------------	--	--	---

Tema e javës: Bota e kafshëve përmes përrallave			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Kafshët shtëpiake	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve për kafshët shtëpiake (kali, lopa, derrkuci, qeni, macja, etj)/ku jetojnë ato/me çfarë ushqehen/fëmijët imitojnë tingujt e tyre, etj.</p> <p>Përralla: “3 derrkucët” (Derrkucët valltarë/Derrkucët e fermës).</p>	Mjete didaktike: letra, gota plastike, spango. Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 26

		<p>Vjershë: “Delja”</p> <p>Loja: Provo forcën e frymës (Loja me gotë dhe litar).</p>	
--	--	--	--

E martë	Kafshët e pyllit Kafshët e xhunglës	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve rreth kafshëve që jetojnë në pyll (ariu, ujku, dhelpra, kaprolli, etj)/demoistrojnë tingujt që lëshojnë ato. Pyet fëmijët se cila kafshë ju pëlqen më shumë?</p> <p>Përralla: “Hirushja”</p> <p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon/fton fëmijët të emërtojnë kafshët që jetojnë në xhungël (luani, zebra, majmuni, etj).</p> <p>Përralla: “Krokodili”</p> <p>Tabela e lotos me kafshë: Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë kafshët e lotos. Kënga: “Në tropik”</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 22
E mërkurë	Bota ujore	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve rreth botës ujore (peshq, balena, delfin)/ku jetojnë ata (det, lum, liqen, oqean). Fëmijët me ndihmën e edukatores rendisin përrallat me personazhet e botës ujore.</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i një akuariumi me peshq, guacka, etj. Peshku me letër me ngjyra dhe grepi.</p> <p>Përralla: “Sirena e vogël”</p> <p>Vjersha: “2 peshqit e kuq”/“Rosat”</p> <p>Loja: Të shkojmë për peshkim (improvizim i një dite peshkimi) kush i jep më shumë peshq pëshkaqenit/loja energjike me top dhe litar.</p>	Mjete didaktike: letra, ngjyra, etj. Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 21
E enjte	Bota e insekteve	Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve për insektet (mizat, milingonat, buburrecat, kërminjtë, fluturat,	Mjete didaktike

		<p>merimangat)/llojet e tyre/ku jetojnë.</p> <p>Aktiviteti: Krijimi i insekteve me duart dhe gishtat e fëmijëve.</p> <p>Fabula: “Milingona dhe gjinkalla”</p> <p>Vjersha: “ Milingona”</p> <p>Kënga: “Moj buburrec”</p> <p>Loja: Loja energjike me shami, me karrige, me top.</p>	
E premte	Kërcim në grup	<p>Përralla: “Gjithnjë e më lart”</p> <p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorët me fëmijët në grupe kërcëjnë, improvizojnë përmes këngëve lëvizore.</p> <p>Këngë lëvizore: “Tingujt e kafshëve”</p> <p>Këngë lëvizore: “Kënga e lejlekut”</p> <p>Lojë e lirë: Me lodra, me kukulla, me kuba , etj.</p>	Mjete didaktike: letra të bardha, lapsa me ngjyra.

Tema e javës: Teatri i kukullave			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Teatri i kukullave	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve për teatrin e kukullave/si është i ndërtuar ai. Në teatër ka shumë aktorë, ata janë të veshur sipas shfaqjes që japin. Ajo pyet/iu shpjegon fëmijëve për teatrin e kukullave për fëmijët.</p> <p>Këngë: Këngë lëvizore, aktivitet me lëvizje ritmike.</p> <p>Përralla: Shikimi në pc/projector i përrallës “Gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra” (teatri i kukullave).</p> <p>Lojë: Lojëra ndijore.</p>	Mjete didaktike: çarçaf, karton, kuti, kukulla të ndryshme, etj. Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 20
E martë	Një shfaqje me animator	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë – Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve rreth animatorëve/ata veshin costume të ndryshme dhe</p>	Mjete didaktike: kartona/lapsa/letra me ngjyra

		<p>organizojnë lojra me fëmijët. Pyeten fëmijët nëse kanë qënë ndonjëherë në një festë apo ditëlindje me animator?</p> <p>Aktiviteti: Përgatitja e shportës me ushqime për gjyshen e Kësulkuqes. Edukatorja fton fëmijët të vendosin në shportë fruta të ndryshme.</p> <p>Improvizim i një shfaqjeje: Edukatorja duke përdorur kukullat prej pellushi, improvizon përrallën “Kësulkuqja” duke përfshirë edhe fëmijët duke i pyetur herë pas here në pjesë të caktuara të përrallës.</p> <p>Loja: Domino/Labirinth/ “Të gjejmë rrugën për në çerdhe”.</p> <p>Vjersha: “Lopa, dhia dhe delja”</p>	
E mërkurë	Kafshët dhe tingujt	<p>Përrallë: Leximi i përrallës “Mamadhia dhe shtatë kecat” Përrallë: Leximi i përrallës “Oh sa ngrohtë”</p> <p>Aktivitet: Të imitojmë tingujt e kafshëve.</p> <p>Këngë lëvizore: “Tingujt e kafshëve”</p> <p>Lojë: Topi në kosh sipas ngjyrave, lojëra e kuba dhe formuese.</p>	<p>Mjete didaktike: ngjyra, letra, gërshërë, etj.</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 22</p>
E enjte	Aktivitet fizike	<p>Përrallë: Leximi i përrallës “Llamba e Aladinit”</p> <p>Aktivitet: Bërja e topit me plastelinë dhe hedhja e tij në kosh/gotën përkatëse sipas ngjyrave. Këngë lëvizore: “Kënga e lejlekut” Loja: Kubi aktivitetit fizik.</p>	<p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 23</p>
E premte	Aktivitet i lirë	<p>Përralla: Leximi ose shikimi në pc ose projektor i përrallës “Maçoku me çizme”</p> <p>Përralla: “Një dragua jo i zakonshëm”</p> <p>Loja: Domino/Labirinth/“Të gjejmë rrugën për në çerdhe”.</p> <p>Aktivitet i lirë: Këngë ritmike, fëmijët kërcejnë të gjithë në grup.</p>	<p>Magnetofon, CD me muzikë</p>

		Lojëra energjike: Lojëra të lira.	
--	--	--	--

MUAJI MARS

Tema mujore: Pranvera

Çfarë duhet të dimë për pranverën? Stina e parë e vitit quhet pranverë. Tre muajt e pranverës janë: Marsi, Prilli dhe Maji. Muaji Mars lidhet me fillimin e pranverës dhe me dukurinë e çeljes së luleve, zgjimin e shumë kafshëve dhe ardhjen e shpendëve shtegtarë. Në pranverë, qielli bëhet i kaltër, ditët zgjaten dhe ora ndryshon. Pranvera është stina e luleve shumëngjyrëshe, koha kur ne admirojmë bukurinë e tyre dhe mbjellim fara të reja. Lulet karakteristike të pranverës janë: manushaqja, trëndafili, jargavani, zambaku, tulipani. Në muajin Mars, në vendin tonë, më 14 Mars, festohet “Dita e Verës”, një festë kombëtare. Gjithashtu Muaji Mars shënon dhe festën e 7 Marsit - Festa e Mësuesve dhe 8 Marsi – Festa e Gruas.

1. **Java I:** Karakteristikat e përgjithshme të stinës së pranverës
2. **Java II:** Njohja me elementet kryesore të stinës së pranverës
3. **Java III:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së pranverës
4. **Java IV:** Flasim për veshjet në pranverë. Mësojmë ngjyrat dhe format.

Tema mujore : Pranvera

Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Karakteristikat e përgjithshme të stinës së pranverës	Njohja me elementet kryesore të stinës së pranverës (moti, natyra dhe bimësia).	Java I
Elementet kryesore të stinës së pranverës	Njohja me disa elemente të stinës (dielli, qielli, ylberi, fluturat, zogjtë) përmes punimeve të dorës dhe vizatimit.	Java II
Njohja me frutat dhe perimet e stinës së pranverës	Njohja e frutave dhe perimeve të stinës përmes demonstrimit dhe përgatitjes së ushqimeve.	Java III
Mësojmë ngjyrat dhe format	Flasim për veshjet në pranverë. Mësojmë ngjyrat dhe format.	Java IV

Java I - Tema e javës: Njohja me karakteristikat e përgjithshme të stinës			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike

<p>E hënë</p>	<p>Karakteristikat kryesore të stinës së pranverës. Ngjyrat e pranverës.</p>	<p>Përralla: “Erdhi pranvera”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve karakteristikat e stinës së pranverës, si: moti(i freskët, i ngrohtë), natyra (çelin lulet, pemët gjelbërohen). Pyet fëmijët si ndryshon moti në pranverë? Pyet fëmijët nëse qielli është blu apo gri? Pyet si ndryshojnë pemët dhe çfarë ngjyre kanë gjethet? Pyet a çelin lulet dhe çfarë ngjyre kanë ato?</p> <p>Shëtitje në oborr me fëmijët (24-36 muajsh) për të parë, prekur, mbledhur gjethe dhe lule (shoqëruar me numërimin dhe emërtimin e ngjyrave).</p> <p>Lojë: Lojë energjike me top ose shami. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Vjersha: “Manushaqe e vogël”. Edukatorja iu shpjegon fillimisht fëmijëve se manushaqja është lulja që lajmëron pranverën.</p> <p>Kënga: “Erdhi pranvera”</p> <p>Loja: “Dominotë me ngjyra”</p>	<p>Gjethe dhe lule</p> <p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 21</p>
<p>E martë</p>	<p>Krijojmë me lulet e pranverës</p>	<p>Kënga: “Erdhi pranvera”</p> <p>Krijimi i tablosë: Ngjitja e gjetheve dhe luleve të mbledhura në oborr (gjatë shëtitjes që kanë bërë një ditë më parë).</p> <p>Vjersha: “Manushaqe e vogël”</p> <p>Lojë: “Libri i përkimit të ngjyrave”</p> <p>Përrallë: “Lepuri dhe breshka”</p>	<p>Mjete didaktike: letra kartoni, ngjitëse, lapsa.</p> <p>Gjethe dhe lule</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 24</p>

E mërkurë	Pranvera me shumë ngjyra	<p>Vjersha: “Mimoza”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se me ardhjen e pranverës natyra gjallërohet me ngjyra të ndryshme të pemëve, luleve dhe gjetheve të gjelbra.</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin modelet/format e figurave të përgatitura më parë nga edukatorët: pemë, gjethe, lule (një lule manushaqe sepse është shumëngjyrëshe ose një lule mimoze).</p> <p>Kënga: “Erdhi pranvera”</p> <p>Lojë: Lojë e lirë me kuba, me lodra, etj.</p>	<p>Mjete didaktike: fletë A4, lapsa me ngjyra</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 23</p>
E enjte	Kartolina ime për festën e 7-8 Marsit	<p>Vjersha: “Mimoza”</p> <p>Përralla: “Një dhuratë e veçantë”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në vendin tonë në 7 Mars festohet dita e Mësuesit. Në 8 Mars, nënat, edukatorët, gjyshet urojnë ditën e Gruas.</p> <p>Punë dore me ngjyrosje: Fëmijët mësojnë se si të bëjnë një kartolinë me lule për 7-8 Marsin.</p>	<p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 27</p>
E premte	Punim dore me plastelinë dhe paraqitje e punimeve të javës	<p>Vjersha: “Dashuria për mamin”</p> <p>Lojë: Lojë energjike me top ose shami. Lojërat të zhvillohen në oborr.</p> <p>Kënga: “Erdhi pranvera”</p> <p>Punë dore me plastelinë: Nën drejtimin e edukatores fëmijët mësojnë të bëjnë një lule me plastelinë.</p> <p>Ekspozitë me punimet e dorës: Fëmijët ekspozojnë punimet e tyre.</p>	<p>Mjete didaktike: pleh, vazo, lule, peceta letre</p>

Java II - Tema e javës: Njohja me elementet kryesore të stinës

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Qielli dhe dielli në pranverë	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve qiellin në pranverë. Çfarë ngjyre ka qielli? A ka re? Ç'ngjyrë kanë? Ku është qielli dhe dielli? (lart apo poshtë/afër apo larg) Çfarë ngjyre ka dielli? Si është, i ngrohtë apo i ftohtë?</p> <p>Shëtitje në oborr me fëmijët 24-36 muajpër të parë dhe për të folur për natyrën.</p> <p>Loja: Lojë energjike: lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat të zhvillohen në oborr.</p> <p>Vjersha: "Dallëndyshja". Edukatorja iu shpjegon fillimisht fëmijëve që dallëndyshja është zogë që lajmëron pranverën. Dallëndyshet i ndërtojnë foletë në pemë, por edhe pranë nsërtesave ku jetojnë njerëzit.</p> <p>Punë dore me vizatim ose ngjyrosje/plastelinë: Dielli</p>	<p>Mjete didaktike: fletë A4, lapsa me ngjyra</p> <p>Libri "Mendoj dhe mësoj", faqe 24</p>
E martë	Krijojmë ylberin	<p>Vjersha: "Dallëndyshja"</p> <p>Punë dore me ngjyrosje/plastelinë: Edukatorja shpjegon fillimisht se ylberi ka shumë ngjyra dhe del pas shiut. Fëmijët me ndihmën e edukatores vizatojnë ylberin në qiell/krijojnë ylberin me plastelinë. Fëmijët ftohen të zgjedhin vetë ngjyrat. Edukatorja mund të përdorë ilustrimet e këtij materiali.</p>	<p>Mjete didaktike: domino, fletë A4, lapsa me ngjyra</p> <p>Libri "Mësoj për shkronjat", faqe 25</p>
		<p>Loja: "Dominotë me ngjyra"</p> <p>Lojë e lirë: me lodra, me kukulla, me kuba, etj.</p>	

E mërkurë	Zogjtë	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se zogjtë shtegtojnë nga vendet e tjera ku ka qënë ngrohtë dhe kthehen përsëri në vende të ngrohta, ku po vjen përsëri pranvera, si p.sh. në vendin tonë. Ajo iu shpjegon se ata kanë sqep, pendë, bisht dhe i ndërtojnë foletë e tyre në pemë, por edhe pranë njerëzve.</p> <p>Vjersha: “Ciu ciu zog i vogël”</p> <p>Vjersha: “Qukapiku”</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin modele zogjsh të përgatitura më parë nga edukatorja.</p> <p>Lojë: Lojë energjike me birila, me karrige.</p>	<p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 28</p>
E enjte	Krijimi i fluturës	<p>Vjersha: “Flutura”</p> <p>Lojë: Lojë energjike me top, shami. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për fluturat, të cilat mbushin lëndinat në stinën e pranverës.</p> <p>Punim dore me ngjyrosje/plastelinë: Fëmijët mësojnë të krijojnë një flutur. Edukatorja udhëheq punën. Edukatorët mund të përdorin modelet e ilustruara në këtë material.</p> <p>Përrallë: “Rosaku i shëmtuar”</p>	
E premte	Mbjellja e lules	<p>Përrallë: “Mësime kopshtarie”</p> <p>Lojë: “Mbjellja e lules” Edukatorët iu kërkojnë prindërve të sjellin nga një lule për ditën e premte. Fëmijët mbjellin lule në oborr ose ujisin lulet e oborrit së bashku me edukatoren.</p> <p>Lojë: Lojë energjike: levizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat të zhvillohen në oborr. Vjersha: “Mos e këput lulen”</p>	<p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 22</p>
		<p>Ngjyrosje apo vizatim i lirë.</p>	

Java III - Tema e javës: Frutat dhe perimet e stinës

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me frutat e stinës së pranverës	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve frutat e stinës, përmes demonstrimit me fruta të vërteta, forma plastike, libra, revista: luleshtrydhja, kajsia, manat, molla, banania, limoni (që janë pothuajse gjatë gjithë vitit).</p> <p>Loja: “Tabelae lotos” (me figura frutash).</p> <p>Vizatim ose ngjyrosje: “Frutat” – Fëmijët ngjyrosin forma të përgatitura më parë nga edukatoret (luleshtrydhe, manaferra, qershi).</p> <p>Lojë: Lojë energjike me karrige, me birila, me shami.</p>	<p>Fleta formati me forma figurash</p> <p>Fruta plastike ose fruta të vërteta</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 25</p>
E martë	Njohja me perimet e stinës së pranverës	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve perimet e stinës, përmes demonstrimit me perime të vërteta, forma plastike, libra, revista: brokoli, bizelet, kërpudha, spinaqi, misri, karrota, patatja (që janë pothuajse gjatë gjithë vitit).</p> <p>Loja: “Tabelae lotos” (me figura perimesh).</p> <p>Gjëgjëza: “Karrota”</p> <p>Punë dore/ngjyrosje: “Kërpudhat”. Fëmijët ngjyrosin forma ose i krijojnë me ndihmën e edukatores.</p>	<p>Fleta formati me forma figurash</p> <p>Perime plastike ose perime të vërteta</p> <p>Mjete didaktike: letra keku, lapsa me ngjyra, letra me ngjyra</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 26</p>
E mërkurë	Përgatitja e ushqimeve	<p>Lojë: Lojë energjike me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, lojë me shami. Lojërat të zhvillohen në oborr.</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve se kush gatuan në çerdhe</p>	<p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 23</p>

		<p>dhe emërton llojet e ushqimeve që konsumojnë fëmijët në drekë. Pyet fëmijët cilat ushqime ju pëlqejnë më shumë? Kush gatuan në shtëpi? Po në çerdhe? Mjetet që përdorim kur gatuajmë.</p> <p>Vizitë në kuzhinë (fëmijët 24-36 muaj): Kuzhinierja iu shpjegon se sip o përgatitet ushqimi i ditës.</p> <p>Lojë imituese: “Bëj sikur gatuaj” Përralla: “Byreku i mbretit”</p>	
E enjte	Etika e të ngrënit	<p>Përrallë: “Çfarë oreksi”</p> <p>Lojë: Lojë energjike me top, shami. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Lojë: “Brumi për të luajtur”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu tregon dhe iu demonstron fëmijëve se si shtrohet tavolina: vendosja e mbulesës, pecetave, lugëve, pjatave dhe gotave. Pyet fëmijët: Çfarë vendosim mbi tavolinë? (emërtohen dhe numërohen elementet). A duhet ti ndihmojmë prindërit/edukatorët në shtrimin e tavolinës? Çfarë duhet të bëjmë para dhe pas buke? (të lajmë duart dhe buzët).</p> <p>Vjersha: “Dreka”</p>	Miell, brumë
E premte	Përgatitja e ëmbëlsirës	<p>Lojë: Lojë energjike me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, lojë me shami. Lojërat të zhvillohen në oborr.</p> <p>Bisedë: Edukatorja pyet fëmijët: A ju pëlqejnë ëmbëlsirat? Emërton disa lloje ëmbëlsirash dhe i pyet fëmijët: Cilat ëmbëlsira ju pëlqejnë më shumë? Kush jua jep / përgatit ëmbëlsirat? Çfarë ëmbëlsirash gatuajmë në çerdhe? Po në shtëpi? Etj.. Lojë: “Bëjmë karamele me fleta me ngjyra”</p> <p>Aktivitet: Përgatitja e ëmbëlsirës. Kuzhinierja iu tregon fëmijëve se si bëhet keku.</p>	Biskota, miell, brumë, fruta dhe ëmbëlsira, karamele.

Java IV - Tema e javës: Mësojmë ngjyrat dhe format

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Veshja e fëmijëve në pranverë Ekspozita e veshjeve	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në pranverë veshim rroba më të lehta se në dimër. Më pas i pyet: Si vishemi në pranverë? A veshim rroba të holla apo të trasha si në dimër? A veshim më pak apo më shumë rroba? A veshim xhupa apo xhaketa/triko/bluza? Edukatorja iu shpjegon veshjet për fëmijë në stinën e pranverës.</p> <p>Ngjyrosje: “Veshjet e fëmijëve” Fëmijët ngjyrosin forma të përgatitura më parë nga edukatorët.</p> <p>Ekspozita: Fëmijët ekspozojnë veshjet e ngjyrosura dhe emërtojnë ngjyrat që kanë përdorur në punimin e tyre.</p> <p>Përralla: “Luani dhe miu”</p>	Fletë me forma për ngjyrosje, ngjyra Libra me përralla
E martë	Numrat 1-5	<p>Bisedë: Edukatorja emërton numrat nga 1 deri në 5 dhe fton fëmijët të përsërisin së bashku numrat. Ajo pyet fëmijët dhe i ndihmon të përgjigjen: Çfarë numri është ky? Sa këpucë janë këtu? Konkretizojmë numrat përmes kategorizimit dhe numërimit të elementeve të ngjashme, p.sh.: 1 bluzë, 2 çorape, 3 kopsa, 4 gota, 5 shishe.</p> <p>Kënga: “Lepuri” (Kënga fillon me numërimin 1, 2, 3, 4, 5)</p> <p>Loja: “Jemi 5 në vaskë”</p> <p>Loja: Lojë e lirë me kukulla, me kuba, etj.</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 27
E mërkurë	Mësojmë format gjeometrike, madhësinë dhe	<p>Bisedë: Edukatorja iu demonstron fëmijëve forma të ndryshme gjeometrike përmes kubave dhe legëve.</p> <p>Aktivitet: Edukatorët përgatisin në format A4 format gjeometrike dhe fëmijët gjejnë legot që përshatën me to. Secili</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 26

	ngjyrat përmes kubave/legovë	prej tyre vendos kubat/legot sipas formës/madhësisë përkatëse në fletën e vet. Fëmijët mësojnë dhe me ndihmën e edukatores të krahasojnë format dhe madhësinë, emërtojnë ngjyrat. Lojë: Lojë e lirë me kukulla, me lego, me top, etj.	
E enjte	Shkojmë për piknik	Vjersha: “Rosaku” Lojë energjike: Me litar në oborr. Aktivitet i orientuar: Fëmijët, nën drejtimin e edukatores, mbledhin fruta për të ngrënë, lodra dhe sende të tjera (që janë në dhomë), të cilat iu nevojiten për të shkuar në një piknik. Përdoret shporta ose çantat, në të cilat vetë fëmijët duhet të zgjedhin sendet që iu duhen. Fëmijët me ndihmën e edukatores emërtojnë sendet që kanë zgjedhur për të future në shportë/çantë. Përrallë: “Pikniku i Arushit Tedi”	Artikuj veshjesh dhe punimesh me dorë
E premte	Luajmë dhe ngjyrosim	Vjersha: “Dallëndyshja” Lojë: Lojë energjike: lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, lojë me shami, me top. Lojërat të zhvillohen në oborr. Vjersha: “Manushaqe e vogël” Kënga: “Erdhi pranvera” Ngjyrosje/vizatim i lirë	Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fletë A4 Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 29

MUAJI PRILL

Tema mujore: Qyteti dhe fshati

Çfarë duhet të dimë për muajin Prill? Muaji Prill është muaji i dytë i stinës së pranverës. Prilli është muaji i luleve, i ngjyrave, i poezisë. Në muajin prill është Dita Ndërkombëtare e zogjve. Muaji Prill është muaji i ndërgjegjësimit për librin. Në muajin Prill është Dita e Balonave.

1. **Java I:** Karakteristikat e qytetit
2. **Java II:** Karakteristikat kryesore të fshatit
3. **Java III:** Njohja me mjetet e transportit
4. **Java IV:** Respektojmë rregullat në komunitet

Tema mujore : Qyteti dhe fshati		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Njohja me karktersitikat kryesore të qytetit	Njohja me karakterstitikat kryesore të një qyteti, si: lagjet, pallatet, rrugët, parqet etj.	Java I
Njohja me karakterstitikat kryesore të fshatit	Njohja me disa nga karkteristikat kryesore të fshatit, si: fusha, pylli, ferma, etj.	Java II
Njohja me mjetet e transportit	Njohja me mjetet e transportit	Java III
Respektojmë rregullat në komunitet	Njohja me rregullat e komunitetit ku banojmë. Njohja me rregullat në çerdhe.	Java IV

Java I - Tema e javës: Njohja me qytetin

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohim qytetin tonë	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për qytetin. Ajo iu demonstron atyre npr librave, revistave, etj pamje nga qyteti. Edukatorja pyet fëmijët nëse ata shkojnë të luajnë te këndet e lojrave ose nëse shkojnë në parqe, lulishte, shëtitore. Edukatorja iu tregon fëmijëve se fëmijët shkojnë në park bashkë me prindërit ose dikë të rritur. Aty luajnë edhe me fëmijë të tjerë.</p> <p>Lojë imituese: “Piknik në qytet” Edukatorja emërton sendet që kanë marrë me vete në piknik. Loja zhvillohet në oborr. Vjersha: “Ora e qytetit”</p> <p>Punë dore: “Qyteti me drita”</p>	<p>Mjete didaktike: foto, revista, libra.</p> <p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 24</p>
E martë	Njohja e qytetit përmes viatimit/ngjyrosjes	<p>Vjersha: “Ora e qytetit”</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për vende në qytet ku fëmijët kalojnë kohën e lirë me familjen, si: Parku I Liqenit, parqet e lojrave, etj.</p> <p>Vizatim: Ngjyrosja e figurave të përgatitura më parë nga edukatorët.</p> <p>Krijimi I tablosë: Ngjitja e figurave për të krijuar qytetin (shoqëruar me emërtimin dhe numërimin e tyre deri në 3). Edukatorja ndihmon fëmijët të ngjisin figurat.</p>	<p>Mjete didaktike: kuba, materiale të ndryshme prej cope</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 28</p>

E mërkurë	Njohja e objekteve historike të qytetit	Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për Tiranën, për objektet historike të saj dhe I pyet fëmijët nëse I kanë vizituar këto vende. Vjersha: “Ora e qytetit” Lojë imituese: Në teatrin e kukullave Krijim: Ndërtimi me kuba i një objekti.	Mjete didaktike: Foto, revista, libra, etj. Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 30
E enjte	Njohja me kafshët shtëpiake	Vjersha: “Shtëpia e bubit” Lojë energjike me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr. Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja flet për kafshët shtëpiake dhe pyet fëmijët nëse ata kanë kafshë në shtëpi? Si quhen ato? A kujdesen për to? Kënga: “Macja le të lahet” Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin kafshë shtëpiake.	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 27
E premte	Krijimi I zogjve me punë dore	Vjersha: “Qukapiku” Lojë energjike: Me shami, me top. Lojërat zhvillohen në oborr. Punë dore: Krijimi i zogjve me letra për kek, me pjata plastike, me plastelinë. Përrallë: “Mbreti I fluturimeve”	Mjete didaktike: letra për kekë, pjata plastike, letra me ngjyra, ngjitëse, etj.

Java II - Tema e javës: Njohja me fshatin

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
ihënë	Njohja e elementëve kryesorë të	Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve pamje nga fshati. Pyet fëmijët se cilët kanë gjyshër/të afërm në fshat. Iu flet fëmijëve për të mirat e fshatit, për prodhimet bujqësore dhe	Mjete rrethanore të ndryshme Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 28

	fshatit	<p>blegtorale duke e ilustruar me produktet që fëmijët konsumojnë në çerdhe.</p> <p>Lojë energjike: “Vigani, shkurtabiqi”</p> <p>Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për malin dhe fushën: mali është I lartë dhe I madh, fusha është e sheshtë. Ajo iu demonstron fëmijëve figura të maleve dhe fushave.</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin/ vizatojnë një mal, një fushë sipas dëshirës.</p> <p>Përralla: “Fuqia e këngës”</p>	
E martë	Njohja e objekteve historike të fshatit	<p>Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se edhe fshati, ashtu si qyteti ka objekte historike. Në fshatrat e Tiranës 2 objekte historike janë: Kalaja e Prezës dhe Kalaja e Petrelës. Edukatorja pyet fëmijët se cili prej tyre i ka vizituar ndonjëherë këto vende?</p> <p>Vjersha: “Kafshët në fermë”</p> <p>Punë dore: Iriqi me plastelinë dhe kunja shkrepsesh Përralla: “Çfarë cirku”</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 29</p>
E mërkurë	Njohja me kafshët që jetojnë në fshat	<p>Vjersha: “Kafshët në fermë”</p> <p>Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve mbi kafshët e fermave të fshatit dhe të mirat që marrim prej tyre.</p> <p>Lojë energjike me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja në oborr.</p> <p>Ngjyrosje: Ngjyrosja e figurave të përgatitura më parë nga edukatorja.</p> <p>Krijimi i tablosë: Ngjitja e figurave në tablonë e mëparshme për të krijuar fshatin.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 31</p>

		Përralla: "Mos lëviz"	
E enjte	Njohja me shpendët që jetojnë në fshat	Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve mbi shpendët e fshatit dhe të mirat që marrim prej tyre. Lojë energjike: "Këngë lëvizore 1" ose "Këngë lëvizore 2" Vjersha: "Rosat në liqen" Ngjyrosje: Ngjyrosja e figurave të përgatitura më parë nga edukatorët, si: zog pule, gjeli, etj. Përralla: "Dhelpra dhe lejleku"	Mjete didaktike
E premte	Krijimi I kafshëve me punë dore	Vjersha: "Kafshët në fermë" Loja: Pula dhe dhelpra. Loja zhvillohet në oborr. Punë dore: Krijimi I kafshëve si qeni, derrkuci, lepuri, etj me letra kartoni, pjata plastike etj. Edukatorja ndihmon fëmijët të ngjisin sytë, hundën, gojën, veshët e kafshëve dhe ndihmon fëmijët ti emërtojnë ato. Kënga: "Bubrrec"	Mjete didaktike

Javga III - Tema e javës: Mjetet e transportit			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Njohja me mjetet e transportit	Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se njerëzit shpikën mjetet e transportit për të udhëtura, për të transportuar mallra, për të komunikuar, për të ndihmuar njerëzit, etj. Mjetet e transportit janë disa llojesh. Edukatorja pyet fëmijët a kanë udhëtuar ndonjëherë me makinë, me autobus, etj? Edukatorja iu përmend profesionet e shoferit, makinistit të trenit, pilotit, timonierit të anijes.	Mjete didaktike Libri "Mendoj dhe mësoj", faqe 30

		<p>Lojë energjike: Me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Këngë: “Gabimi i Mirelës”</p> <p>Loja imituese: “Si pilot ose si kapiten anije”</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin modele të mjeteve të transportit.</p>	
E martë	Njohja me mjetet e transportit npr lojës	<p>Kënga: “Autobusi”</p> <p>Lojë energjike me shami. Loja zhvillohet në oborr. Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja demonstron mjetet e transportit që na ndihmojnë në situatë rreziku, që janë të shpejta dhe të pajisura me mjete shpëtimi.</p> <p>Vizatim: Ngjyrosja e figurave të përgatitura më parë nga edukatoret.</p> <p>Krijim: Ngjitja e figurave për të krijuar një park automjetesh.</p>	Mjete didaktike Modele për ngjyrosje
E mërkurë	Mjetet e transportit tokësor	<p>Vjersha: “Treni”</p> <p>Lojë energjike: Me shami, me top.</p> <p>Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se mjetet e transportit tokësor janë mjetet që ecin në tokë, si: makina, treni, etj.</p> <p>Kënga: “Autobusi”</p> <p>Loja: Ngjyrat e makinave dhe numërimi I tyre.</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 25
E enjte	Mjetet e transportit ujor dhe detar Krijimi I një balone	<p>Bisedë Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për mjetet e transportit ajror. Fëmijët emërtojnë së bashkë edukatoren mjetet e transportit.</p> <p>Punë dore: Ndërtimi i një balone.</p> <p>Bisedë: Edukatorja përmend mjetet e transportit ujor dhe fton fëmijët ti emërtojnë ato. Vjersha: “Si marinar”</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 30

		Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin mjetet e transportit ujor dhe detar të përgatitura më parë nga edukatorët.	
E premte	Krijojmë një aeroplan dhe një varkë me punë dore	Vjersha: “Treni” Lojë energjike: me shami, me top. Loja zhvillohet në oborr. Punë dore: Aeroplani me karrotë Kënga: “Autobusi” Punë dore: Varka. Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin një varkë prej letre.	

Java IV - Tema e javës: Respektojmë rregullat në komunitet			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Rregullat e sjelljes në çerdhe	Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rëndësinë e rregullave kur qëndrojmë së bashku në çerdhe. Disa nga rregullat që fëmijët duhet të dinë janë: -Të luajmë së bashku dhe të ndajmë lodrat me njëri tjetrin. -Të mos shtyjmë/lëndojmë/godasim shokun/shoqen. -Të hamë të gjithë bashkë dhe të zbatojmë rregullat e të ngrënit. -Të mbajmë pastër veten. -Të mbajmë pastër ambjentin e kopshtit/çerdhes. Aktivitet në natyrë: Fëmijët dalin në oborr dhe bashkë me edukatoren mbledhin mbeturinat, gjethet e pemëve dhe i hedhin në kosh. Lojë energjike me top. Vjersha: “Mirëmëngjes”	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 31

E martë	Ecim në vijat e bardha Semafori	Vjersha: "Mirëmëngjes" Bisedë: Edukatorja flet për vijat e bardha dhe rregullat e qarkullimit. Kënga: "Prit sinjalin pastaj ik" Krijim: Krijimi i semaforit, vendosja e vijave të bardha	Mjete didaktike Libri "Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format", faqe 26
		Aktivitet: Improvizimi i një situatë në semafor. Përralla: "Gishtëza"	
E mërkurë	Të duam të respektojmë natyrën	Vjersha: "Mos e këput lulen" Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se duhet ta duam dhe ta respektojmë natyrën. Ajo iu kujton fëmijëve se lulet nuk këputen, mbeturinat nuk i hedhim në det, liqen, lumë. Lulet dhe pemët zbukurojnë ambientin dhe pastrojnë ajrin. Edukatorja pyet fëmijët: Kush ka lule në shtëpi? Kush kujdeset për to? Aktivitet në natyrë: Edukatorja së bashku me fëmijët ujin një lule në oborrin e çerdhës. Vjersha: "Mirëmëngjes" Lojë e lirë: me kuba, me lodra, kukulla, etj.	Mjete didaktike Libri "Mendoj dhe mësoj", faqe 29
E enjte	Fjalët magjike	Vjersha: "Mirëmëngjes" Lojë energjike me shami. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për fjalët magjike dhe rëndësinë e tyre në ambientin ku jetojmë. Ajo pyet fëmijët se cili/cila prej tyre mund të thotë një fjalë magjike. Aktivitet: Inskeni i situatave të ndryshme ku themi fjalë magjike. Kënga: "Fjalët magjike" Vjersha: "Lisharsi"	Mjete didaktike Libri "Mësoj për kafshët", faqe 32

E premte	Krijimi I luleve	Kënga: “Fjalët magjike” Lojë e lirë energjike me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja në oborr. Vjersha: “Mos e këput luken” Punë dore: Krijimi i luleve të ndryshme me letër, ngjyra, plastelinë me ndihmën e edukatores. Muzikë: Fëmijët dëgjojnë muzikë dhe kërcëjnë.	Mjete didaktike
-----------------	------------------	---	-----------------

MUAJI MAJ

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat

Çfarë duhet të dimë për muajin Maj? Muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve. Maji është quajtur muaji i biçikletave. Në muajin Maj piqen luleshtrydhet. Muaji Maj është quajtur muaji i fotografisë. Në muajin Maj çelin luleboret, tulipani dhe trëndafili.

1. **Java I:** Format e argëtimit
2. **Java II:** Lojërat me ngjyrat
3. **Java III:** Lojërat me numrat
4. **Java IV:** Përgatitemi për 1 Qershorin

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit

Format e argëtimit	Të njohim fëmijët me format e argëtimit. Disa elementë të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në aspektin social dhe argëtues të jetës së tyre.	Java I
Lojërat me ngjyrat	Përsëritja e ngjyrave kryesore përmes punës së dorës dhe lojrave.	Java II
Lojërat me numrat	Përsëritja e numrave 1-10 dhe organizimi i lojërave dhe aktiviteteve me këta numra.	Java III
Përgatitemi për 1 Qershorin	Koncerti festiv dhe shkëmbim dhuratash	Java IV

Java I - Tema e javës: Format e argëtimit			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike

<p>E hënë</p>	<p>Sporti dhe rëndësia e tij</p>	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për sported dhe rëndësinë e tyre për shëndetin. Sportet na mësojnë të luajmë në grup. Disa lojëra zhvillohen në skuadër si psh: futbo;;o, volejboli, etj, ndërsa në disa sporte garojmë vetëm si psh: noti, vrapi, etj.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë për rregullat e futbollit dhe mjetet për të lozur atë:</p> <p>-Futbolli luhet me top dhe me 2 skuadra me uniforma të ndryshme. Futbolli luhet në fusha ose stadiume dhe drejtohet nga arbitri. Futbolli është lojë shumë e dashur dhe lojtarët respektojnë njëri tjetrin. Skuadra jonë e zemrës është Shqipëria.</p> <p>Loja e futbollit: Edukatorja ndihmon dhe mëson fëmijët të godasin topin me këmbë. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Lojra me top: Edukatorja zhvillon lojëra të ndryshme me top në oborr.</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Përralla: “Ndeshje në fushëgjelbër”</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin një top të përgatitur më parë nga edukatorja.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 32</p>
<p>E martë</p>	<p>Njohja me lojën e volejbollit</p>	<p>Bisedë edukatore-fëmijë për rregullat e volejbollit dhe mjetet për të luajtur volejboll:</p> <p>Krijimi i dy skuadrave, zbatimi i rregullave të lojës, përdorimi i topit, rrjetave dhe uniforma e veshjes për secilën skuadër. Një arbitër vëzhgon lojën gjatë gjithë kohës.</p>	<p>Mjete didaktike</p>
		<p>Loja e volejbollit: Loja zhvillohet në oborr.</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Punë dore: Krijimi i topave me plastelinë.</p>	

E mërkurë	Loja e tenisit	<p>Vjersha: “Balona”</p> <p>Loja e tenisit: “Të luajmë tenis me tullumbace” Jepini fëmijëve nga një tullumbac, lerimi të lirë të zgjedhin ngjyrë që dëshirojnë. Ndhimojini fëmijët ët godasin tullumbacin me raketë. Loja zhvillohet në oborr. Përralla: “Stërvitja”</p> <p>Lojë e lirë: me top, me kuba, etj.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 33</p>
E enjte	Loja e basketbollit	<p>Bisedë edukatore-fëmijë për rregullat e basketbollit dhe mjetet për të lozur atë:</p> <p>Krijimi i dy grupeve me fëmijë, zbatimi i rregullave të lojës duke hedhur topin në koshin me rrjet.</p> <p>Loja e basketbollit: Loja zhvillohet në oborr.</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Lojë e lirë: me top, me kuba, etj.</p>	<p>Libri i vjershave dhe lojërave</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 32</p>
E premte	Mësojmë të vizatojmë një buzëqeshje	<p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Lojë energjike: me shami, me top, me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se muaji maj është muaji i buzëqeshjeve. Ajo fton fëmijët të imitojnë me mimikë një buzëqeshje.</p> <p>Aktivitet: Fëmijët mësojnë të vizatojnë fytyrën e buzëqeshur dh eta ngjyrosin atë sipas dëshirës. Përralla: “Kampioni i notit”</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Fletë të verdha, shkopinj Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 27</p>

Tema e javës: Njohja me ngjyrat

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Ngjyra e kuqe	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”</p> <p>Lojë energjike: me shami, me top, etj.</p> <p>Vjersha: “Qershia”</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e kuqe dhe se ku e gjejmë atë në natyrë. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të kuqe që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Punë dore: Krijimi i gaforres së detit.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 33</p>
E martë	Ngjyra e gjelbër	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”</p> <p>Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e gjelbër dhe se ku e gjejmë atë në natyrë. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të gjelbër që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Bisedë: Bretkosa. Edukatorja iu flet fëmijëve për bretkosën, ku qëndron ajo, tingullin që lëshon, etj. Fëmijët imitojnë tingullin e bretkosës.</p> <p>Përralla: “Bretkosa e gjelbër”</p> <p>Ngjyrosje ose punë dore: Fëmijët ngjyrosin me ndihmën e edukatores bretkosën.</p>	<p>Mjete didaktike</p>
E mërkurë	Ngjyra blu	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën blu dhe se ku e gjejmë atë në natyrë. Edukatorja</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Tullumbace blu, letra, etj.</p>

		<p>ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë blu që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Aktivitet me tullumbace: Fëmijët me ndihmën e edukatores fryjnë tullumbace blu, të kaltra dhe lozin me to. Aktiviteti zhvillohet në oborr.</p> <p>Vjersha: “Tullumbace të kam xhan”</p>	
E enjte	Ngjyra e verdhë	<p>Vjersha: “Karrota”</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e verdhë dhe se ku e gjejmë atë në natyrë. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të verdhë që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Lojë energjike: Këngë lëvizore 1 ose 2.</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin lulen ose bletën. Lojë e lirë: me top, me lodra, me lego, etj</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Objekte me ngjyrë të verdhë</p> <p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 34</p>
E premte	Ngjyra portokalli	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën portokalli dhe se ku e gjejmë atë në natyrë. Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë portokalli që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Lojë energjike: me shami, me top, me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Përralla: “Tri fluturat”</p> <p>Punë dore me plastelinë: Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë ylberin me plastelinë.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 31</p>

Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Përsërisim numrat 1-5	<p>Vjersha: “Më gëzon në maj ti mua” Lojë energjike: me shami, me top, etj.</p> <p>Përsërisim numrat: Përsërisim numrat nga 1-5. Edukatorja ndihmon fëmijët të përsërisin numrat nga 1-5 duke përdorur 5 shqisat e njeriut.</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin rrethorët me numra nga 1-5 të përgatitura më parë nga edukatores. Vjersha: “Lepuri”</p> <p>Vjersha: “1, 2, 3”</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 34
E martë	Krijimi I krimbit me numrat 1-5	<p>Vjersha: “Më gëzon në maj ti mua”</p> <p>Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.</p> <p>Vjersha: “Lepuri”</p> <p>Punë dore: Ngjitja e numrave te krimbi I formuar nga rratjët me numra. Fëmijët, me ndihmën e edukatores, ngjisin numrat 1-5 sipas renditjes në fletën e vizatuar. Pas renditjes, me ndihmën e edukatores, fëmijët emërtojnë dhe ngjyrat. Përralla: “Tri fluturat”</p>	Mjete didaktike Fleta me ngjyra, numra
E mërkurë	Krijimi i krimbit me numrat 6-10	<p>Vjersha: “Më gëzon në maj ti mua” Lojë energjike: me shami, me top, etj.</p> <p>Punë dore: Ngjitja e numrave 6-10 te krimbi I formuar nga rathët me numra.</p> <p>Përralla: “Notoj dhe fluturoj”</p>	Mjete didaktike Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 28
E enjte	Numërojmë përmes	<p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p> <p>Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga</p>	Mjete didaktike

	shqisave	<p>edukatorja.</p> <p>Ngjyrosje: Ngjyros arushën.</p> <p>Aktivitet/ Numërojmë shqisat e arushit: Pas ngjyrosjes edukatorja pyet fëmijët: Sa sy ka arushi? Sa veshë? Sa këmbë? Sa duar? Fëmijët I numërojnë pjesët e trupit të arushit sipas pyetjeve që bën edukatorja.</p> <p>Përralla: “Brunoja, arushi bojë kafe”</p>	
E premte	Mësojmë të rradhisim	<p>Vjersha: “Më gëzon në maj ti mua” Loja e trenit: Loja zhvillohet në oborr.</p> <p>Vjersha: “Lepuri”</p> <p>Punë dore: Fëmijët në bashkëpunim me edukatoren rradhisin sende, lodra të çerdhes, etj. Edukatorja nxit të gjithë fëmijët të rradhisin dhe të ëmërtojnë deri në 5 sendet.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 33</p>

Java IV - Tema e javës: Lojra me fëmijët			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Krijimi i kapeles	<p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Lojë energjike: me top. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Bisedë: Edukatorja bisedon me fëmijët lidhur me festën e 1 Qershorit. Çfarë është festa e 1 Qershorit, çfarë bëjnë fëmijët gjatë festës. Iu tregon se do të bëhet një festë gjatë saj, iu tregon se ata aty do të recitojnë, luajnë dhe këndojnë.</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Punë dore: Kapelet e 1 Qershorit. Edukatorët me fletë kartoni bëjnë kapele për festat duje ia treguar fëmijëve.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 35</p>

E martë	Ngjyrosja ose zbukurimi i kapeles	<p>Vjersha: “Më gëzon në maj ti mua”</p> <p>Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Punë dore: Edukatorët ngjyrosin ose ngjisin topa me ngjyra të kapelet e tyre duke i pyetur fëmijët për ngjyra e topave apo zbukurimeve dhe cilat ngjyra ata pëlqejnë në kapelet e tyre.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 29</p>
E mërkurë	Përgatitim vjersha, këngë dhe kartolina për festën e 1 Qershorit.	<p>Vjersha: “Dallëndyshja”</p> <p>Përralla: “Tri fluturat”</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p>	<p>Kuti kartoni, letra të vogla me ngjyra</p> <p>Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 34</p>
E enjte	Përgatitim vjersha, këngë dhe kartolina për festën e 1 Qershorit.	<p>Vjersha: “Tullumbace të kam xhan”</p> <p>Përralla: “Tri fluturat”</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Ngjyrosje/punë dore: Krijojmë kartolinat për 1 Qershorin. Fëmijët ngjyrosin me ndihmën e edukatoreve lulet e pranverës duke krijuar një kartolinë për shokun/ shoqen.</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Libri i vjershave dhe këngëve</p>
E premte	Përgatitim vjersha, këngë dhe kartolina për festën e 1 Qershorit.	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Lojë e lirë</p>	<p>Mjete didaktike</p> <p>Punë dore e lirë</p> <p>Libri “Mësoj për kafshët”, faqe 35</p>

MUAJI Qershor

Tema mujore: Njohja me karakteristikat e stinës së verës

Çfarë duhet të dimë për muajin Qershor? Muaji Qershor është muaji i parë i verës dhe nis me një ditë të rëndësishme për fëmijët – 1 Qershorin! Në qershor ne shijojmë frutat e qershisë, pjeshkës, qershisë, etj.

1. **Java I:** Festa e 1 Qershor-it. Karakteristikat e stinës së verës.
2. **Java II:** Frutat dhe perimet e stinës.

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat		
Temat javore	Synimet	Koha e realizimit
Festa e 1 Qershor-it. Karakteristikat e stinës së verës.	Programi festiv. Njohja me disa nga karakteristikat e stinës së verës.	Java I
Frutat dhe perimet e stinës.	Njohja me frutat dhe perimet e stinës.	Java II

Java I - Tema e javës: Festa e 1 Qershor-it. Karakteristikat e stinës së verës.			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	1 Qershori, festa ime!	Aktivitet festiv: Fëmijët nën drejtimin e edukatoreve realizojnë programin festiv në grupe/ çerdhe duke iu referuar këngëve dhe vjershave të mësuara gjatë muajit maj.	

E martë	Karakteristika të stinës së verës	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve stinën e verës. Në verë është më nxehtë se në stinët e tjera. Dita është më e gjatë se nata. Dielli lind më shpejt dhe ngroh më shumë. Kur vjen vera ne bëjmë banja dielli. Vjersha: “Dielli”</p> <p>Loja: Futja e rrathëve në kon</p> <p>Loja: Roza rozina.</p> <p>Këngë lëvizore</p>	Libri “Mendojmë dhe mësojmë”, faqe 35
E mërkurë	Qielli, yjet dhe hëna	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në verë qielli është i pastër dhe i kthjellët. Netëve të verës hëna dhe yjet duken më qartë.</p> <p>Vjersha: “Ylli i vogël”</p> <p>Loja: Pikturimi me gishta</p> <p>Loja energjike: Lojëra ritmike me muzikë të drejtuara nga edukatorja.</p> <p>Përralla: “3 derrkucët”</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 36
E enjte	Ngjyrat në natyrë	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për ngjyrat në verë. Deti, qielli janë blu. Rrezet e diellit janë të verdha. Bari dhe pemët janë të gjelbërta. Lulet janë të kuqe, rozë, të bardha, etj.</p> <p>Vjersha: “Dielli”</p> <p>Loja: “Me rërë dhe ujë”</p> <p>Përralla: “Mbreti i notit”</p>	Libri “Mësoj për numrat, ngjyrat dhe format”, faqe 30
E premte	Zogjtë Pulëbardhat Mjellmat	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rreth këtyre zogjve. Iu tregon se zogjtë nuk kanë gëzof, por kanë pupla, kanë krahë dhe fluturojnë lart. Pulëbardhat, mjellmat i shohim pranë liqenit dhe detit.</p> <p>Aktivitet i improvizuar në grup: “Rrahim krahët si zogjtë” –</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 37

		<p>edukatore orientojnë fëmijët të lëvizin krahët si zogjtë. Vjersha: “Këmbët dhe krahët e shpendëve” Loja: me kuba, me top, etj. Përralla: “Sos pulëbardha”</p>	
--	--	---	--

Tema e javës:			
Dita/Data	Tema ditore	Organizimi i veprimtarisë ditore	Libri/Materialet/ Mjetet didaktike
E hënë	Frutat e stinës së verës	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/ demonstron fëmijëve përmes figurave dhe revistave frutat e stinës. Ajo emërton figurat bashkë me fëmijët frutat si: qershia, pjeshka, kajsia, pjepri, etj. Vjersha: “Qershia” Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se qershia i ka kokrrat të vogla, me ngjyrë të kuqe, vishnje, të verdhë në portokall. Aktivitet: “Vendosja e frutave sipas formave” Ngjyrosje: “Qershia” Përralla: “Lepurushja Matildë”</p>	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 38
E martë	Frutat e ëmbla të verës: qershia, manaferra, luleshtrydhe	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për frutin e qershisë, manaferrës dhe luleshtrydhs (forma, madhësia, ngjyra). Me qershia, manaferra, luleshtrydhe mund të bëjmë reçel, akullore dhe ëmbëlsira të ndryshme. Vjersha: “Qershia” Loja: “Futja e frutave në shportë” – emërtimi dhe klasifikimi i frutave sipas llojit dhe ngjyrës. Përrallë: “Reçeli” Gjëgjëza: “Manaferra”</p>	Libri “Mendoj dhe mësoj”, faqe 36

		Muzikë: Lojëra ritmike të drejtuara nga edukatorja.	
E mërkurë	Krijojmë frutat me punë dore	Vjersha: “Qershia” Krijimi i frutave me punë dore: Fëmijët, duke përdorur format e ndryshe dhe me ndihmën e edukatores mësojnë të bëjnë frutat me plastelinë. Loja: “Tuneli” Loja energjike: “Vigani dhe shkurtabiqi” Përrallë: “Reçeli”	
E enjte	Mjalti dhe bleta punëtore	Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për bletën dhe veçantinë e saj. Bleta është punëtore dhe shëtit nëpër lule. Nga bleta marrim mjaltin. Me mjalt bëjmë ëmbëlsira, biskota dhe na bën mirë për grykët. Shoku më i mirë i mjaltit është ariu. Vjersha: “Bletës” Loja energjike: “Kërcimi në vend” Loja: “Bërja e flluskave” Përrallë: “Një llupës i madh”	Libri “Mësoj për shkronjat”, faqe 39
E premte	Perimet e stinës	Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve perimet e stinës së verës: domatja, kastravec, bishtajat, kungulli, etj. Perimet kanë vitamina, na bëjnë të fortë, të shëndetshëm. Supa, sallata me perime që përgatit kuzhinierja, prindërit janë shumë të shijshme. Vjersha: “Karrota” Gjëgjëza: “Domatja” Loja: “Të gjithë në tren/ Me top” Përrallë: “Ferma e lepujve” Këngë lëvizore: 1, 2	